



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Shkenca Komunikimi”, me profile: “Marrëdhënie me Publikun”;
“Gazetari”
ofruar nga
Kolegji Universitar “Bedër”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Diana Kalaja
Dr. Ilda Kashami

Shtator /2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: Marrëdhënie me Publikun;
Gazetari"

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASH Nr.10, datë 16.01.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 8, datë 28.02.2022 dhe Urdhër MAS Nr. 9, datë 28.02.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr. 29, datë 12.04.2019 (me kohëzgjatje 6 vite akademike, me vlefshmëri deri më 11.04.2025)
8	Cikli i studimit:	Cikli 2
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022-2023: PAE/ PAK 7/2 Viti akademik 2023-2024: PAE/ PAK 7/1 Viti akademik 2024-2025: PAE/ PAK 8/1
18	Numri i studentëve:	Viti akademik 2022-2023: 9

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

		Viti akademik 2023-2024:	11
		Viti akademik 2024-2025:	17
	Komente / të tjera:	-	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" i ofruar nga Kolegjit Universitar "BEDER" (KU BEDER) përfaqëson një program studimi, në përputhje me kërkesat e arsimit të lartë, bazën ligjore dhe aktet nënligjore të miratuara si nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ashtu edhe ato të vetë institucionit.

Akreditimi i parë institucional është bërë me Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013, dhe riakredituar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL me vendimin nr. 101 datë 10.11.2017. KU Bedër ka kryer riakreditimin institucional dhe me Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 57 datë 16.12.2021 është riakredituar institucionalisht deri në vitin 2026.

Akreditimi i parë, i programit të studimit "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi me profilet: Gazetari dhe Marrëdhënie Publike" është sipas Vendimit Nr. 29, datë 12.04.2019, të Bordit të Akreditimit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Njësia bazë për këtë program studimi është Departamenti i Shkencave të Komunikimit. Programi zgjat 2 vite/4 semestra dhe ka 120 kredite (ECTS).

Objekti kryesor i këtij programi është pajisja e studentëve me njohuritë dhe informacionin e duhur në fushën e komunikimit, si dhe në disiplinat humane që e mbështesin atë. Kjo arrihet duke inkurajuar mendimin kritik, inovacionin dhe aspiratën për të arritur sukses si brenda ashtu edhe përtej institucionit, duke u dhënë mundësi studentëve të aplikojnë vlerat dhe informacionet e fituar në çdo aspekt të karrierës së tyre.

Programi i studimit "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi me profilet: Gazetari dhe Marrëdhënie Publike" ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e shkencave të komunikimit, medias, imazhit të organizatave, marrëdhëniet e të punësuarve dhe fushatave publike, etj. Programi i ka thellimit profesional të njohurive të gazetarit dhe specialistët të medias të një numri të gjerë studentësh, të cilët e kanë zgjedhur atë, krahas edhe vijimit të punës në mediat e ndryshme.

KU Bedër ka thelluar bashkëpunimin me kompanitë që veprojnë në biznesin mediatik në vend, si edhe bashkëpunimin me projekteve universitare në kuadër të network ndërkombëtare me universitete të huaja. Programi i studimit u ka krijuar mundësi studentëve dhe pedagogëve të përfshihen në programe mobiliteti dhe shkëmbimi më universitet të tjera në Evropë si edhe më programe të mbështetura nga USAID/Ambasada e USA në Tiranë. Departamenti i Shkencave të Komunikimit, përgjegjës për këtë program studimi, është pjesëmarrës në projekte të COST dhe Erasmus +.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për realizimin e vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" të Kolegjit Universitar BEDER, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u njoh fillimisht me bazën dokumentare të përcjellë nga institucioni pranë ASCAL. Aty përfshiheshin plani mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloret e programit të studimit, informacione mbi strukturat mbështetëse, marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione për realizimin e praktikave mësimore, marrëveshje dhe projekte në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, udhëzues dhe mjaft evidenca të tjera mbështetëse, të cilat ofronin një pamje të qartë mbi organizimin dhe menaxhimin e programit.

Në datat 26 dhe 27 mars 2025, grupi zhvilloi takime, sipas një agjende të koordinuar nga ekspertja e ASCAL me institucionin, të cilat ishin planifikuar paraprakisht sipas një agjende të detajuar dhe të dakordësuar me institucionin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Dr. Diana Kalaja dhe Dr. Ilda Kashami. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Rajna Lila.

Gjatë takimeve në institucion, GVJ bisedoi me personelin akademik, drejtuesit dhe studentët, si edhe përfaqësues të zyrave të ndryshme brenda KU Bedër duke mbledhur informacione të rëndësishme rreth praktikave të mësimdhënies, metodologjive të vlerësimit dhe kritereve të parashikuara në standardet e formatit të raportit për vlerësimin e jashtëm. Takimet dhanë një informacion plotësues dhe të drejtpërdrejtë mbi ecurinë, rezultatet dhe sfidat me të cilat përballen studentët dhe pedagogët, si dhe mbi eficiencën e metodave të mësimdhënies të aplikuara.

Pas marrjes së informacionit dokumentar dhe realizmit të takimeve, GVJ analizoi me kujdes gjithë informacionin e grumbulluar, duke i referuar këto informacione/dokumente në hartimin e një raporti të detajuar. Ky raport përfshin një analizë të gjitha standardeve dhe kritereve të vlerësimit të programit, duke u siguruar që secili aspekt të jetë vlerësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara. Një element kyç i raportit është analiza SWOT e programit, e cila identifikon pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që ndërlidhen me zbatimin e tij. Raporti paraqet një vështrim të kujdesshëm mbi performancën e programit të studimit dhe ofron një bazë për rekomandimet e mëtejshme, duke u fokusuar në strategjitë për përgatitjen profesionale të studentëve.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 29, datë 12.04.2019 janë:

Institucioni të punojë në të ardhmen për rritjen e pjesëmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare universitare, përfshirjen në network-e universitare, pjesëmarrjen në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, si ato rajonale dhe më gjerë edhe në bashkëpunim me universitetet të tjera.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Një ndër objektivat themelore të Kolegjit Universitetit Bedër ka qenë edhe pjesëmarrja gjithnjë e më të madhe në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor, dhe sidomos në projekte me universitete të tjera. Në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit, në qershor 2020, institucioni KU Bedër ka hartuar një plan veprimi për përmbushjen e këtij rekomandimi. Institucioni ka intensifikuar punën për pjesëmarrje në projekteve ndërkombëtare siç janë ato të Erasmus+. KU Bedër ka lidhur dy marrëveshje në kuadër të këtyre programeve:

- "Pontifical University of Salamanca" në kuadër të Erasmus+ KA171
- "Universitatea de vest din Timisoara, Faculty of Sciences Political, Philosophy and Communication Sciences".

Dokumenti mbi pjesëmarrjen të studenteve në programe shkëmbimi jep një pasqyrë të lëvizjes së studentëve në të tilla programe.

Gjithashtu, studentët kanë qenë edhe pjesëmarrës në projektet e ofruar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, nëpërmjet USAID dhe Ambasadës amerikane si SUSI dhe UGrad.

Edhe stafi akademik, mbështetur në marrëveshjet e realizuara ka marrë pjesë në programe shkëmbimi në projekte të COST dhe Erasmus +.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie Publike"; "Gazetari".

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i Studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari", në Kolegjin Universitar "Bedër" është konceptuar në përputhje me misionin e institucionit për të ofruar arsim cilësor në përputhje me zhvillimet moderne dhe nevojat e tregut të punës në fushat e komunikimit, gazetarisë dhe marrëdhënieve publike. Strategjia institucionale mbështet zhvillimin e programeve që ndihmojnë formimin profesional dhe kërkimor të studentëve, duke respektuar standardet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmbajtja dhe struktura e programit janë koherente me këtë vizion. <i>Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 56: Plani Strategjik Institucional 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 57: Plani Strategjik Institucional 2024-2028</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi" me profile, "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" reflekton në mënyrë të qartë qëllimet institucionale të Kolegjit Universitar Bedër për të promovuar një edukim të bazuar në vlera, inovacion dhe përgatitje profesionale të studentëve. Struktura kurrikulare është ndërtuar për të përmbushur objektivat formuese në fushën e komunikimit dhe për t'u përshtatur me një treg pune në zhvillim, çka është në linjë me misionin për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie demokratike përmes edukimit cilësor. Përmbajtja akademike e programit është në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë akademike të institucionit dhe fushat prioritare të zhvillimit që ai mbështet. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 50: Organigrama e Kolegjit Universitar "Bedër"</i>

	<i>Evidenca nr. 49: Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i> <i>Evidenca nr. 5: Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 93: Rregullorja e Bordit të Administrimit</i> <i>Evidenca nr. 102: Rregullorja mbi Organizimin Akademik</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike të Institucionit.	Programi i studimit është konceptuar në përputhje me dokumentet themelore të institucionit si Strategjia e Zhvillimit, Statuti dhe Rregulloret përkatëse akademike. Hartimi i programit reflekton prioritetet institucionale për zhvillim të qëndrueshëm akademik, përfshirë përforcimin e kërkimit shkencor, ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin profesional të studentëve në përputhje me fushat e profilizuara të institucionit. Zbatimi i këtyre dokumenteve është evident si në strukturën e kurrikulës, ashtu edhe në mënyrën e organizimit të praktikave profesionale dhe përfshirjen e moduleve të avancuara në komunikim dhe media. Përputhja me drejtimit akademike të Kolegjit është e qartë dhe konsistente. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është konceptuar në përputhje me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë dhe nevojën për formimin e profesionistëve të aftë në fushën e komunikimit publik dhe medial. Përmbajtja e programit pasqyron një balancë mes kontekstit vendas dhe zhvillimeve ndërkombëtare në disiplinën e komunikimit. Përfshirja e moduleve që trajtojnë çështje globale si etika mediatike, teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit, si dhe menaxhimi i marrëdhënieve me publikun, dëshmon për përafrim me trendet ndërkombëtare në arsim dhe përputhje me rekomandimet e dokumenteve si Bologna Process dhe European Qualifications Framework. Programi kontribuon gjithashtu në ruajtjen e interesit kombëtar përmes promovimit të gazetarisë cilësore dhe komunikimit institucional të përgjegjshëm. <i>Evidenca nr. 56: Plani Strategjik Institucional 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 57: Plani Strategjik Institucional 2024-2028</i>
Konkluzione	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni dhe analizën e përmbajtjes së programit "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi", konstatohet se programi është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e Kolegjit Universitar Bedër. Hartimi dhe ofrimi i programit reflekton besnikërisht dokumentet themelore të institucionit si Statuti,

	<i>Rregullorja dhe Strategjia e Zhvillimit. Ai është ndërtuar në përputhje me fushën e veprimtarisë akademike të institucionit dhe adreson në mënyrë të qartë prioritetet e strategjive kombëtare për arsimin dhe zhvillimin, si dhe prirjet globale në fushën e komunikimit. Struktura dhe përmbajtja e programit demonstrojnë përputhshmëri me interesin publik, duke përfshirë dimensionin etik, kulturor dhe praktik të formimit profesional të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Kolegji Universitar Bedër ka një histori të konsoliduar në zhvillimin e programeve në fushën e komunikimit, duke përfshirë ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Njësia bazë përgjegjëse për programin është Departamenti i Shkencave të Komunikimit, i cili disponon kapacitete të përshtatshme akademike dhe infrastrukturore për të mbështetur ofrimin cilësor të këtij programi. Stafit akademik i angazhuar përbëhet nga pedagogë me grada shkencore dhe përvojë të konsiderueshme në fushat përkatëse të gazetarisë, marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit institucional. Gjithashtu, departamenti ka zhvilluar veprimtari kërkimore dhe projekte të lidhura me fushën, duke demonstruar kapacitete të qëndrueshme për të ofruar një program studimi të nivelit të dytë në këtë drejtim. <i>Evidenca nr. 20: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas	Programi “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” i përket fushës së shkencave shoqërore dhe është në përputhje të plotë me drejtimin akademik të njësive bazë (Departamenti i Shkencave të Komunikimit) dhe të institucionit në tërësi. Fusha akademike e programit, që fokusohet në gazetari dhe marrëdhënie publike, është e mirënjohur dhe e zhvilluar brenda Kolegjit Universitar Bedër, si në aspektin mësimor ashtu edhe kërkimor. Struktura dhe përmbajtja e programit përputhen me klasifikimin e përcaktuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe direktivat evropiane për programet master në fushën e komunikimit.

direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<i>Evidenca nr. 29: Njoftim mbi kodifikimin e programeve të studimit</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi”, ndërthur natyrshëm komponentët e gazetarisë, komunikimit dhe marrëdhënieve publike, të gjitha të mbuluara nga njësia bazë përgjegjëse. Departamenti përkatës demonstroi përputhshmëri të qartë të fushës akademike me programin që ofron, si në aspektin e moduleve mësimore, ashtu edhe në përvojën kërkimore të stafit. Nuk ka mungesë përputhshmërie midis profilit të programit dhe kapaciteteve akademike të njësisë bazë. <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike”</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”, “Gazetari”
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni ofron aktivitete dhe trajnime të karakterit profesional për studentët e diplomuar, të cilat synojnë përditësimin dhe thellimin e aftësive të tyre në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përmes Zyrës së Karrierës dhe bashkëpunimit me institucione të medias, organizohen seminare, workshop-e dhe trajnime të hapura që lidhen me zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun.
Konkluzione	<i>Programi i studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profilet përkatëse është në përputhje të plotë me fushën akademike të njësisë bazë përgjegjëse dhe mbështetet në traditën dhe kapacitetet ekzistuese të institucionit në këtë fushë. Ky program synon të avancojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve në fushën e komunikimit, duke u bazuar në një kurrikul të hartuar në përputhje me zhvillimet më të fundit shkencore dhe praktike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Institucioni ka një profil të qartë akademik në fushën e komunikimit, të dëshmuar përmes një përvoje të gjatë dhe të dokumentuar në mësimdhënie dhe kërkime shkencore. Aktivitetet kërkimore të stafit akademik dhe bashkëpunimet me institucione të tjera arsimore dhe</i>

	organizata të fushës janë dëshmi e përkushtimit ndaj cilësisë akademike dhe zhvillimit profesional. Njësia akademike që mbështet programin përmbush të gjitha kërkesat për kapacitete njerëzore dhe kërkimore. Staf i akademik përbëhet nga pedagogë me kualifikime të larta, të cilët zotërojnë grada shkencore dhe kanë eksperiencë në fushën e komunikimit, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Përveç kësaj, struktura organizative dhe burimet e disponueshme, përfshirë bibliotekën, laboratorët dhe mjetet teknologjike, sigurojnë një bazë të qëndrueshme për ofrimin me cilësi të lartë të këtij cikli studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Struktura organizative dhe funksionale e Kolegjit Universitar Bedër siguron ndarje të qartë të përgjegjësisë mes njësive akademike dhe administrative për mbarëvajtjen e programit. Departamenti i Shkencave të Komunikimit është i angazhuar në mënyrë aktive në hartimin, monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit përmes analizave të brendshme, takimeve periodike dhe vlerësimeve të rezultateve. Procesi i përditësimit të planit mësimor është i koordinuar mirë dhe përfshin aktorët institucionalë përkatës. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 45: Mbledhja e Këshillit të Departamentit për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë</i> <i>Evidenca nr. 18: Vendim për caktimin e Këshilltarëve Akademikë për programet Master, viti akademik 2024-2025</i> <i>Evidenca nr. 17: Vendim për caktimin e asistentit të Departamentit pranë NJSBC-së</i> <i>Evidenca nr. 73: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës</i> <i>Evidenca nr. 16: Vendim për caktimin e asistentit pranë Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare</i>

	Evidenca nr. 82: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për të garantuar realizimin me cilësi të lartë të objektivave të procesit mësimor dhe formues të studentëve, institucioni vendos dhe zhvillon marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione homologe, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij si Itali, Poloni, Rumani, Kroaci, Spanjë, Turqi, etj. Këto bashkëpunime synojnë të krijojnë një mjedis akademik dinamik dhe të ndërkombëtarizuar, duke u ofruar studentëve mundësi të zgjeruara për shkëmbim përvojash, ekspertize dhe praktika të mira në fushën e shkencave të komunikimit, shkëmbime studentësh dhe stafesh, zhvillim të përbashkët projektsh kërkimore, organizim konferencash, workshop-esh dhe trajnimesh. Gjithashtu, pjesëmarrja në programe ndërkombëtare si Erasmus+ ka ndihmuar në forcimin e lidhjeve akademike dhe në rritjen e ekspozimit ndërkombëtar të studentëve dhe pedagogëve. Evidenca nr. 44: Marrëveshje mobiliteti Erasmus +
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Koleji Universitar Bedër ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, si media të njohura, organizata të shoqërisë civile, si dhe institucione publike që operojnë në fushën e komunikimit. Këto marrëveshje sigurojnë terren për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve dhe krijojnë hapësira për përfshirjen në projekte kërkimore ose formuese. Në shumë raste, bashkëpunimi me punëdhënësit përfshin jo vetëm ofrimin e praktikës, por edhe mbikëqyrjen e saj, përmes raportimeve të strukturuar dhe vlerësimit të performancës së studentëve. Lidhjet e krijuara me institucionet pritëse ndikojnë pozitivisht në përgatitjen praktike dhe mundësitë e punësimit pas diplomimit. Shtojca: Tabela nr. 5: Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese Evidenca nr. 110: Shembull aplikimi praktike
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të	Njësia përgjegjëse për programin e studimit zhvillon reflektime dhe analiza të brendshme mbi bashkëpunimet me partnerët institucionalë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e programit. Raportet analitike që evidentojnë në mënyrë të strukturuar

përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	përfitimet nga këto marrëveshje (si ndikimi në cilësinë e praktikës, përmirësimi i përmbajtjes së moduleve, përfshirja e partnerëve në vlerësimin e studentëve, etj.) janë të dokumentuara në mënyrë të rregullt dhe sistematike. Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se: Programi i studimit "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi" mbështetet në një rrjet të gjerë marrëdhëniesh bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat luajnë një rol thelbësor në realizimin e praktikave profesionale dhe në thellimin e komponentit praktik të programit. Këto marrëdhënie janë të strukturuar dhe të institucionalizuara përmes marrëveshjeve të posaçme bashkëpunimi me aktorë kryesorë të fushës së komunikimit, përfshirë media kombëtare dhe ndërkombëtare, agjenci të marrëdhënieve me publikun dhe reklamës, institucione kërkimore, organizata të shoqërisë civile dhe kompani teknologjike të specializuara në komunikim digjital.</i> <i>Përmes këtyre partneriteteve, studentët kanë mundësinë të përfshihen drejtpërdrejt në praktika reale pune, të cilat zhvillohen si pjesë e integruar e kurrikulës. Këto përfshirje jo vetëm që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të studentëve, por gjithashtu kontribuojnë në ndërtimin e një profili të qartë karriere, të orientuar drejt tregut të punës.</i> <i>Përveç praktikave profesionale, bashkëpunimet me partnerë të jashtëm mundësojnë edhe përfshirjen e ekspertëve të fushës në procesin e zhvillimit të moduleve mësimore, duke garantuar që përmbajtja e programit të jetë gjithmonë në përputhje me zhvillimet më të fundit të industrisë dhe të përditësuar me kërkesat e tregut. Kjo ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së programit dhe në përshtatshmërinë e tij me nevojat aktuale dhe të ardhshme të profesionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profile, është ndërtuar mbi parimet e strukturës së përcaktuar nga kuadri ligjor shqiptar për arsimin e lartë dhe është në përputhje me sistemin ECTS. Të gjitha veprimtaritë formuese – përfshirë lëndët teorike, praktikat profesionale, kërkimin shkencor dhe përgatitjen e temës së diplomës – janë të organizuara dhe të vlerësuara me kredite, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane. Struktura e planit mësimor është transparente dhe i mundëson studentit të ndjekë progresin akademik në mënyrë të qartë dhe të matshme. Përcaktimi i ngarkesës së punës për secilin modul është bërë në harmoni me praktikën e sistemit ECTS, duke pasur në qendër rolin aktiv të studentit në procesin mësimor. <i>Evidenca Shtojca, Tabela nr.9 - Plani mesimor i ndare sipas Veprimtarive Formuese</i> <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Programi Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile, synon të zhvillojë një profil profesional dhe akademik të specializuar, duke përgatitur studentët për të punuar në një gamë të gjerë rolesh në fushat e gazetarisë, marrëdhënieve publike dhe komunikimit strategjik. Përmbajtja e programit ofron njohuri të avancuara teorike dhe praktike, të strukturuar rreth moduleve që trajtojnë teorinë e komunikimit, etikën mediatike, menaxhimin e informacionit dhe komunikimin institucional. Qasja pedagogjike nxit të menduarit kritik dhe zgjidhjen e situatave të paparashikueshme, duke përfshirë raste konkrete dhe simulime në mjedise të ngjashme me ato të punës. Kjo mbështet zhvillimin e kompetencave të nevojshme për një treg pune dinamik dhe për përballimin e sfidave në mjedise profesionale të ndërlikuara.

fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit "Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" përfshin lëndën e Praktikës Profesionale me kod COM612, me një ngarkesë prej 12 ECTS dhe Detyrimet përmbyllëse "Teza" me kodin COM 610 me një ngarkesë prej 18 ECTS si komponentë të detyrueshëm të planit mësimor. Të dyja këto aktivitete janë të strukturuar dhe të vlerësuara në mënyrë të qartë me kredite, në përputhje me kërkesat e sistemit ECTS dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi. Praktika profesionale zakonisht zhvillohet gjatë semestrit të fundit dhe shoqërohet me mbikëqyrje nga stafi akademik dhe nga institucioni pritës. Teza zhvillohet në semestrin e katërt dhe finalizohet pasi studentët kanë përmbyllur të gjitha detyrimet e tjera lëndore. <i>Evidenca nr. 69: Procedura e praktikës profesionale</i> <i>Evidenca nr. 74: Procesverbali i mbledhjes së komitetit shkencor të Departamentit për vlerësimin e propozimit të tezave</i> <i>Evidenca nr. 41: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Ky kriter nuk aplikohet për programin Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun" "Gazetari". (N/A)
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari".

formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Kolegji Universitar Bedër nuk është një institucion i arsimit të lartë me status të veçantë në Republikën e Shqipërisë.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Përmbajtja e kurrikulës së Programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” është në përputhje me standardet akademike të programeve homologe në institucione të tjera të arsimit të lartë brenda vendit dhe në rajon. Modulet themelore të përfshira në program – si teoritë e komunikimit, kërkimi shkencor, etika dhe marrëdhëniet publike – përbëjnë bazën e përbashkët të fushës dhe përmbushin kriterin e krahasueshmërisë së përmbajtjes në nivel të paktën 70%, siç kërkohet nga udhëzimet përkatëse.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Ky program studimit është shoqëruar me kodin përkatës 72MS0388S, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të publikuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke siguruar që të gjitha programet e ofruara të jenë të standardizuara dhe të njohura në nivel kombëtar. Për më tepër, kodifikimi i lëndëve të programit është realizuar në përputhje me këtë sistem, duke mundësuar një organizim të qartë dhe transparent të të gjitha moduleve dhe kurseve të përfshira.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në	Programi “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profile, ofrohet ekskluzivisht nga Kolegji Universitar Bedër dhe nuk është i strukturuar si program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. Si i tillë, ky kriter nuk është i zbatueshëm për këtë program konkretisht.

përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione	<i>Programi Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" është ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore kombëtare dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Strukturimi i programit, shpërndarja e krediteve, përfshirja e praktikës profesionale dhe e punimit të diplomës janë të përcaktuara qartë dhe mbështesin zhvillimin e kompetencave të avancuara akademike dhe profesionale. Programi synon përgatitjen e studentëve për një gamë të gjerë rolesh në fushat e komunikimit, gazetarisë dhe marrëdhënieve publike, duke integruar njohuri teorike dhe praktike në funksion të zgjidhjes së situatave të ndërlikuara profesionale.</i> <i>Përputhshmëria prej 70% e programit të studimit me programet e tjera të ngjashme siguron një nivel të lartë të koherencës dhe standardizimit brenda fushës së studimit. Programi është gjithashtu i kodifikuar dhe i strukturuar në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me klasifikimet dhe kërkesat e ligjshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, së bashku me Departamentin e Shkencave të Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin "Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi" me profilet: <i>Marrëdhënie me publikun dhe Gazetari</i>, funksionon në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. Struktura akademike është e dokumentuar dhe funksionale, me ndarje të qarta të përgjegjësiave mes drejtuesve të programit, stafit akademik dhe personelit mbështetës. Njësia bazë përbëhet nga 11 anëtare PAE ndër ta: 1 Profesor i Asociuar, 2 me gradën Doktor, 8 asistentë-lektorë (MSC) dhe staf PAK ndër ta 1 Prof.Dr.; 1 Dr ; 3 Msc dhe një personel ndihmës akademik.

	Të dhëna për Departamentin i Shkencave të Komunikimit:						
	Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024		2024-2025	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof.Dr.	-	2	-	2	-	1
	Prof. Asoc.	-	-	-	-	-	-
	Dr./PhD.	4	1	3	-	3	1
	Msc.	8	4	7	4	8	3
	Totali	12	7	10	7	11	5
Evidenca nr. 49: Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë							
Evidenca nr. 104: Vendim për Ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB)							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga evidencat e vëna na dispozicion GJV vëren se njësia bazë përgjegjëse për programin demonstroi angazhim të qëndrueshëm në mbështetjen e realizimit të praktikave profesionale përmes bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet stafit akademik dhe atij ndihmës/administrativ. Ky angazhim siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor praktik dhe garanton mbështetjen e nevojshme teknike e organizative për zhvillimin e moduleve që kërkojnë ndërveprim të drejtpërdrejtë të studentëve me mjedise laboratorike apo profesionale. Struktura mbështetëse funksionon në përputhje me standardet e përcaktuara dhe kontribuon ndjeshëm në rritjen e cilësisë së përvojës akademike për studentët. Stafi administrativ angazhohet në menaxhimin logjistik dhe dokumentar të procesit, ndërsa stafi ndihmës akademik kontribuon në orientimin dhe ndjekjen e përmbajtjes së praktikës në përputhje me objektivat mësimore. Ky organizim përmbush kërkesat ligjore për mbështetjen institucionale të komponentit praktik të programit.						
Evidenca nr. 94: Rregullorja e Disiplinës së Personelit Akademik dhe Administrativ							

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” ka të caktuar një koordinator përgjegjës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Koordinatori akademik është anëtar i stafit me kualifikim të përshtatshëm dhe përvojë në menaxhimin e programeve të ngjashme dhe caktohet me vendim departamenti. Ai luan një rol kyç në mbikëqyrjen e zhvillimit të kurrikulës, koordinimin e aktiviteteve mësimore dhe ndërlidhjen me partnerët për realizimin e praktikave profesionale. Roli i koordinatorit është i përcaktuar qartë në dokumentet e brendshme të institucionit dhe realizohet në bashkëpunim të ngushtë me departamentin përgjegjës dhe strukturat mbështetëse. Ky mekanizëm kontribuon në mirëfunksionimin e programit dhe në garantimin e cilësisë së tij. <i>Evidenca nr. 82: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit</i> <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 107: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik</i>			
Konkluzione	Njësia bazë përgjegjëse për programin “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” në Kolegjin Universitar Bedër përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për organizimin dhe funksionimin e programeve të ciklit të dytë. Struktura akademike është e qartë dhe funksionale, me ndarje të përcaktuara të përgjegjësive ndërmjet stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Institucioni siguron mbështetje të vazhdueshme për organizimin e praktikave profesionale dhe ka përcaktuar një koordinator programi që mbikëqyr ecurinë e përgjithshme të programit, në përputhje me objektivat mësimorë dhe profesionalë. Këto elemente garantojnë funksionimin efektiv të programit dhe zhvillimin e tij të vazhdueshëm në linjë me kërkesat kombëtare të cilësisë në arsim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profilet përkatëse, disponon informacion të plotë dhe të mirëstrukturuar lidhur me të gjitha aspektet e programit. Këto informacione përfshijnë planin mësimor të detajuar, përshkrimin e moduleve, qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta të programit, si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Dokumentacioni i programit është i disponueshëm për studentët, stafin akademik dhe palët e interesit përmes platformave të institucionit dhe materialeve zyrtare. Kjo transparencë ndihmon në koordinimin e procesit mësimor dhe në orientimin e qartë të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve. Kjo gjë gjithashtu konstatohet në rregulloret dhe ne Statutin e këtij Institucioni. <i>Evidenca nr. 1: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”</i> <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar “Bedër”</i> <i>Evidenca nr. 96: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i> <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” përmban një plan mësimor të strukturuar në mënyrë të qartë, i cili përfshin ndarjen e moduleve sipas semestrave, numrin e krediteve për çdo lëndë, si dhe ngarkesën mësimore të organizuar në orë mësimore brenda dhe jashtë auditorit. Këto të dhëna janë të përfshira në dokumentacionin zyrtar të programit dhe pasqyrojnë përputhje me kuadrin rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me parimet e sistemit ECTS. Struktura e planit ndihmon në organizimin e procesit mësimor dhe në lehtësimin e ndjekjes së progresit të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve. Gjithashtu, për secilën lëndë janë të hartuara syllabuset përkatëse, të cilat përfshijnë qëllimet, rezultatet e të nxënit, përmbajtjen tematike, metodologjinë e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit dhe literaturën bazë. Këto dokumente garantojnë transparencë, udhëheqje të qartë për stafin pedagogjik dhe orientim për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve.

	<i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i> <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 112: Shembull Sylabusi</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari", paraqitet i detajuar dhe mirë i strukturuar, duke reflektuar në mënyrë të qartë parashikimet dhe objektivat formuese të ciklit të dytë të studimeve. Kurrikula është organizuar në mënyrë logjike, me një ndarje të qartë të moduleve dhe lëndëve që mbulojnë aspektet teorike dhe praktike të fushës. Në lidhje me informacionin që i ofrohet studentëve, programi përmban dokumentacion të plotë dhe të qartë lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në program, si dhe me rregullat për transferimin dhe ekuivalentimin e krediteve. Kjo transparencë ndihmon studentët që të planifikojnë me efikasitet rrugën e tyre akademike dhe të kuptojnë qartë rregullat e studimit, duke siguruar një proces të drejtë dhe të harmonizuar me praktikatat ndërkombëtare. <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion GVJ-ja konstaton se Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë, ku janë përfshirë qartë përmbajtjet, qëllimet, dhe rezultatet e pritura të mësimnxënies. Informacioni për praktikatat, seminarët dhe orët e laboratorit është i strukturuar në përputhje me kërkesat dhe formatet e miratuara nga institucioni, duke reflektuar një qasje të plotë dhe të balancuar midis komponentëve teorikë dhe praktikë. Syllabuset e vëna në dispozicion janë në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Ky nivel i detajimit i syllabuseve ndihmon studentët të përgatiten më mirë për pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor dhe siguron transparencë në pritshmëritë akademike dhe profesionale. Për më tepër, përfshirja e komponentëve jashtë auditorit, si praktikatat

	profesionale, është e dokumentuar mirë dhe kontribuon në zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Evidenca nr. 112: Shembull Sylabusi			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë takimit me stafin akademik të departamentit GVJ konstatohet se përmirësimi i programeve të studimit dhe përputhshmëria me ndryshimet e tregut është objekt përmirësimi dhe përditësimi të vazhdueshëm, duke siguruar që ai të mbetet në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën përkatëse të studimit, kërkesat e tregut të punës dhe kërkesat ligjore. Procesi i miratimit të ndryshimeve në fillim të çdo viti akademik është i organizuar dhe formal, duke siguruar një mekanizëm efektiv për rishikimin e programit në bazë të zhvillimeve në fushën e Shkencave të Komunikimit dhe nevojave të tregut të punës. Ky proces përmirësimi i vazhdueshëm siguron që programi të mbetet cilësor, i përditësuar dhe i përshtatshëm për nevojat e studentëve dhe për sfidat e reja të fushës akademike dhe profesionale. Shtojca: Tabela nr. 14: Modelli i syllauseve, elementet sipas VKM 41/218. Evidenca nr. 112: Shembull Sylabusi			
Konkluzione	<i>Struktura dhe kurrikula e programit janë të qarta, të detajuara dhe të organizuara në përputhje me qëllimet formuese të ciklit të dytë, duke siguruar një balancë të mirë midis teorisë dhe praktikës. Dokumentacioni i programit është i plotë dhe ofron informacion të nevojshëm për studentët në lidhje me pranimin, transferimin, ekuivalentimin dhe komponentët formues të studimit.</i> <i>Procesi i përmirësimit dhe përditësimit të përmbajtjes është i institucionalizuar dhe funksional, duke reflektuar një angazhim për t'u përshtatur me ndryshimet në fushën akademike dhe tregun e punës. Arkivimi në dy gjuhë është një praktikë pozitive që rrit transparencën dhe aksesueshmërinë.</i> <i>Në përgjithësi, programi ka potencial të lartë për të ofruar një arsim cilësor në fushën e Shkencave të Komunikimit dhe për të përgatitur profesionistë të mirëfilltë në Gazetari dhe Marrëdhënie Publike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Struktura dhe organizimi i Programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari”, janë në përputhje të qartë me objektivat formuese të ciklit të dytë, si dhe me nivelin e kualifikimit të përcaktuar nga Kuadri Kombëtar dhe ai Evropian i Kualifikimeve. Programi është i konceptuar në mënyrë të tillë që të përmbushë rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e kërkuara, duke i dhënë një rëndësi të veçantë përshtatjes me kërkesat reale të tregut të punës. Emërtimi i lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive janë të përshtatura në mënyrë që të mundësojnë jo vetëm thellimin e njohurive teorike, por edhe zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave është e balancuar dhe e menduar për t’i dhënë studentëve mundësi për zhvillim akademik të mëtejshëm ose përgatitje të mirë për punësim në fushat e gazetarisë dhe marrëdhënieve publike. <i>Evidenca nr. 63: Praktika e miratimit të ndryshimeve në kurrikulën e programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektiveve formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve në vitet dhe semestrat e programit të studimit është bërë në mënyrë të mirëorganizuar dhe koherente, duke siguruar një progres të qëndrueshëm në ndërtimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Vlerësimi në kredite dhe orët mësimore është në përputhje me standardet e Kuadrit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), duke lehtësuar njohjen ndërkombëtare të studimeve dhe mobilitetin akademik. Plan i mësimor i këtij programi studimi përbëhet nga 120 ECTS dhe organizohet në 2 vite akademike, të ndarë në 4 semestra me 32 javë në vit, përfshirë edhe javët e provimeve. Programi i studimit është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

	Vlerësimi në kredite dhe orët mësimore për secilën lëndë janë të përcaktuara qartë për të siguruar një balancë mes mësimdhënies teorike dhe atyre praktike. <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit "Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i> <i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" është në përputhje të mirë me profilin e programit dhe objektivat e tij formuese. Raporti midis pjesës teorike dhe praktikës është i balancuar dhe i përshtatur për të përgatitur studentët me njohuri të thelluara, si dhe me aftësi praktike të domosdoshme në fushën e komunikimit. Për më tepër, strukturat dhe lëndët e programit janë të përshtatshme dhe të përafërta me ato të programeve ndërkombëtare të ngjashme, duke siguruar një përputhshmëri me praktikat më të mira dhe standardet globale. Programi siguron një fokus të fortë në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave praktike, duke kontribuar në formimin profesional të thelluar të studentëve, që është thelbësor për suksesin e tyre në mjediset profesionale të gazetarisë dhe marrëdhënieve publike. <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit "Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja e programit të studimit sipas veprimtarive formuese është organizuar në mënyrë që të sigurojë një balancë të duhur midis formimit teorik dhe praktik. Kjo ndarje kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave formues të programit, duke ndihmuar studentët të zhvillojnë kompetenca të plota akademike dhe profesionale. Struktura e programit mbështet gjithashtu transferimin e studimeve dhe mobilitetin akademik, përputhësisht me standardet e Kuadrit Evropian të Kualifikimeve dhe sistemin ECTS. Kjo i lejon studentët

	të njohin dhe ekuilibrojnë lehtësisht kreditet, duke hapur mundësi për studime të mëtejshme apo për integrim në tregun e punës. Gjithashtu, raporti i ekuilibruar mes formimit teorik dhe praktik ndihmon në përgatitjen e studentëve për punësim të suksesshëm, duke u siguruar atyre aftësitë dhe njohuritë që kërkohen nga sektori profesional. <i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përfshirje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Bazuar në syllabuset që u vunë në dispozicion të GVJ lëndët e ofruara në këtë program studimi janë të organizuara në literaturë të detyruar dhe literaturë të rekomanduar e cila i përket viteve të fundit. Përditësimi i syllabuseve të lëndëve dhe moduleve është një aspekt i rëndësishëm i programit dhe është realizuar në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që kompetencat që fitojnë studentët janë në përfshirje me kërkesat aktuale të tregut të punës. Përfshirja e literaturës bazë dhe ndihmëse të përditësuar, kryesisht nga vitet e fundit, pasqyron një angazhim për mbajtjen e materialeve mësimore në përfshirje me zhvillimet më të fundit akademike dhe profesionale. Ky proces përmirësimi bazohet në analizën e vazhdueshme të rezultateve të të nxënës, në workshop-et e organizuara nga Departamenti, në sugjerimet e stafit akademik dhe shpesh në konsultimet me aktorët e tregut të punës, duke siguruar që programi të jetë i orientuar drejt praktikës dhe i dobishëm për integrimin profesional të studentëve. <i>Evidenca nr. 46: Mbledhje e Këshillit të Departamentit për diskutimin e syllabuseve</i> <i>Evidenca nr. 84: Syllabus-et e lëndëve të programit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është e ndërtuar në mënyrë të tillë që garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për studentët. Struktura e kurrikulës dhe përzgjedhja e lëndëve janë të orientuara drejt zhvillimit të njohurive të thelluara teorike, si dhe aftësive praktike që janë të domosdoshme për sfidat profesionale në fushat e gazetarisë dhe marrëdhënieve publike. Programi përfshihet me objektivat formuese dhe standardet e kërkuara për nivelin e ciklit të dytë, duke siguruar që studentët të

	jenë të përgatitur për punësim dhe studime të mëtejshme. Gjithashtu, përmbajtja e programit nxit zhvillimin e kompetencave kërkimore, duke përgatitur studentët edhe për angazhim në aktivitete shkencore dhe profesionale në nivel të avancuar. <i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit është konceptuar në mënyrë që t'u mundësojë studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në cikle të larta akademike (doktoratë ose specializime të avancuara), si dhe integrimin në tregun e punës, në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë aktuale të këtij tregu. Programi përfshin module të avancuara që zhvillojnë aftësi analitike, kritike dhe praktike, të cilat janë thelbësore si për vazhdimin e karrierës akademike, ashtu edhe për punësim në profile të ndryshme si gazetari, marrëdhënie publike, komunikim institucional, menaxhim mediatik apo konsulencë komunikimi. Kjo shumëllojshmëri kompetencash i bën të diplomuarit më fleksibël dhe të përshtatshëm për pozicione të ndryshme pune, në sektorin publik dhe privat. Gjithashtu, përmbajtja është ndërtuar në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të fushës dhe reflektimet e tregut të punës, duke e bërë programin funksional dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete. <i>Evidenca nr. 109: Studim Tregu i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>
Konkluzione	<i>Programi i Studimit të Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari", paraqet një strukturë dhe organizim të mirëkonsideruar që është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, si dhe me kërkesat e tregut të punës.</i> <i>Struktura e programit, ndarja e moduleve në vite dhe semestra, shpërndarja e krediteve, si dhe raporti mes teorisë dhe praktikës janë në funksion të zhvillimit të kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve. Programi garanton përfitim të dijeve të thelluara dhe të aplikueshme, të cilat shërbejnë si bazë për punësim të suksesshëm ose për ndjekjen e studimeve të mëtejshme.</i>

	Përmbajtja e syllabus-eve reflekton përditësim të vazhdueshëm, si në drejtim të literaturës së përdorur ashtu edhe në përputhje me zhvillimet në fushën e komunikimit dhe medias. Për më tepër, profili profesional dhe kërkimor i programit është i përputhshëm me standardet ndërkombëtare, duke mundësuar mobilitet dhe krahasueshmëri akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Procesi i hartimit dhe përmirësimit të programit të studimit në Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” tregon një përpjekje të dukshme për të përfshirë aktorët e jashtëm relevantë, si institucionet partnere, të diplomuarit dhe përfaqësues të tregut të punës. Kjo qasje reflekton një kuptim të nevojës për përshtatjen e vazhdueshme të përmbajtjes akademike me zhvillimet dinamike të tregut të punës dhe kërkesat e reja profesionale. Njësitë përgjegjëse për programin deklarojnë se zhvillojnë konsultime periodike dhe analizojnë sugjerimet e aktorëve të jashtëm për të përmirësuar lëndët, komponentët praktikë dhe qasjet mësimore. Përfshirja e të diplomuarve në këtë proces, si dhe komunikimi me partnerë institucionalë dhe profesionalë, përbën një praktikë të mirë që duhet ruajtur dhe thelluar më tej. <i>Evidenca nr. 109: Studim Tregu i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të	Institucioni tregon një angazhim pozitiv për të përfshirë studentët në proceset e diskutimit dhe vlerësimit të programit të studimit. Studentët dhe strukturat përfaqësuese të tyre (si këshillat studentorë) janë të përfshira në mënyrë periodike në mbledhje, konsultime apo vlerësime të brendshme, duke kontribuar me sugjerime dhe komente për përmirësimin e përmbajtjes dhe cilësisë së programit.

studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Të diplomuarit janë pjesë e procesit të vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të studimit me anë të anketës “Vlerësimi i të diplomuarëve për cilësinë e programit të studimit” Gjithashtu, mbajtja e kontakteve me studentët e diplomuar përmes kanaleve formale ose informale reflekton një përpjekje për të ndjekur rrugëtimin e tyre profesional dhe për të marrë feedback mbi përgatitjen që kanë marrë gjatë studimeve. Ky informacion përdoret në mënyrë konstruktive për të reflektuar dhe rishikuar elementë të programit, veçanërisht në raport me zhvillimet aktuale të tregut të punës. <i>Evidenca nr. 43: Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit</i> <i>Evidenca nr. 40: Listë-prezencë e Këshillit të Departamentit me Pjesëmarrjen e Studentëve</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit në Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” tregon një vëmendje të vazhdueshme ndaj përmirësimit dhe përditësimit të kurrikulës në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse. Ky përditësim bazohet si në zhvillimet akademike dhe kërkimore, ashtu edhe në realitetet e tregut të punës dhe nevojat e profesionit, në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të fushës. Programi përfiton nga ndërveprimi me rrjete profesionistësh, institucione mediatike, agjenci të marrëdhënieve me publikun, si dhe nga kontaktet me institucione të tjera publike dhe private që kontribuojnë me njohuri të përditësuara dhe me nevojat reale të industrisë së komunikimit. Ky bashkëpunim ndihmon në përshtatjen e përmbajtjes mësimore me standardet bashkëkohore dhe përgatitjen e studentëve për sfidat konkrete të tregut.
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” reflekton përpjekje të qëndrueshme për përmirësim të vazhdueshëm nëpërmjet përfshirjes së aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në hartimin, zhvillimin dhe përshtatjen e përmbajtjes së tij.</i> <i>Konsultimi me partnerë institucionalë, përfaqësues të tregut të punës dhe alumni përbën një praktikë pozitive që ndihmon në mbajtjen e programit të azhurnuar dhe të përshtatur me nevojat reale të fushës së komunikimit. Gjithashtu, përfshirja aktive e</i>

	<i>studentëve dhe strukturave të tyre kontribuon në një proces reflektues dhe përmirësues që rrit cilësinë e programit.</i> <i>Njësia përgjegjëse tregon angazhim për përditësimin e përmbajtjes akademike në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e komunikimit, si dhe për ndërtimin e urave me rrjete profesionistësh dhe institucione të fushës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” demonstroi një përpjekje për të përcaktuar objektiva të qarta në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Objektivat e programit janë të formuluar në përputhje me misionin institucional dhe synojnë thellimin e njohurive teorike e metodologjike në fushën e komunikimit, si dhe aftësimin e studentëve për të ndërmarrë projekte kërkimore me relevancë akademike dhe profesionale. Në përmbajtjen e programit theksohet zhvillimi i kapaciteteve kërkimore përmes lëndëve të dedikuara për metodologjinë e kërkimit, si dhe përmes punimit të temës së diplomës, që shërben si pikë kulmore e aplikimit të aftësive analitike dhe shkencore të fituara. Programi inkurajon orientimin e temave të kërkimit drejt çështjeve aktuale në medie, komunikim publik, teknologji dhe shoqëri, duke ruajtur një lidhje të natyrshme me zhvillimet e tregut dhe shoqërisë, duke qenë kështu në përputhje të plotë me fushat kryesore që mbulon Kolegji Universitar “Bedër”. <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit “Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike”</i> <i>Evidenca nr. 56: Plani Strategjik Institucional 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 57: Plani Strategjik Institucional 2024-2028</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe	Njësia bazë që administron programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile përkatëse tregon përpjekje për të bashkërenduar në mënyrë funksionale aktivitetet e

administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	mësimdhënies me ato kërkimore, duke ruajtur një ekuilibër të shëndetshëm ndërmjet përmbajtjes akademike dhe zhvillimeve kërkimore. Promovimi i lirisë akademike dhe respektimi i fushës së specializimit të stafit janë aspekte që evidentohen si pjesë e filozofisë së mësimdhënies dhe kërkimit në këtë program. Personeli akademik ka liri për të propozuar dhe zhvilluar tema kërkimore që lidhen ngushtë me fushat e tyre të ekspertizës, çka ndikon pozitivisht në cilësinë dhe përmbajtjen e mësimdhënies. Përveç kësaj, inkurajimi i përfshirjes së studentëve në procese kërkimore, nëpërmjet detyrave, projekteve apo tezave, kontribuon në ndërlidhjen mes mësimi dhe kërkimit. <i>Evidenca nr. 72: Procedura për mbështetjen e pjesëmarrjes në konferenca</i> <i>Evidenca nr. 115: Udhëzim mbi Nxitjen e Publikimeve dhe Kërkimit Shkencor</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile përkatëse integron në mënyrë të dukshme komponentin kërkimor në strukturën dhe përmbajtjen e tij, duke krijuar hapësira për angazhimin aktiv të studentëve në studime dhe projekte kërkimore. Lëndët që trajtojnë metodologjinë e kërkimit, si dhe detyrimet e parashikuara për përgatitjen e tezës së diplomës, shërbejnë si instrumente efektive për orientimin dhe përfshirjen graduale të studentëve në veprimtari me karakter shkencor. Gjithashtu, studentët inkurajohen të trajtojnë tema aktuale dhe të ndërdisiplinuara, që lidhen me zhvillimet në medie, teknologji, komunikim institucional apo marrëdhënie me publikun. Kjo qasje ndihmon në zhvillimin e aftësive analitike dhe hulumtuese, të domosdoshme për nivelin e ciklit të dytë të studimeve. <i>Evidenca nr. 75: Programi i Konferencës Studentore dhe lista e studentëve pjesëmarrës</i> <i>Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni	Njësia bazë që mbulon programin Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile përkatëse ka mbështetje institucionale për realizimin e veprimtarive akademike dhe kërkimore, edhe pse niveli dhe struktura e financimit mund të jetë i kufizuar. Mjetet financiare sigurohen nga institucioni, nëpërmjet Bordit të Administrimit të KU

dhe administrojnë të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Bedër, i cili çdo vit akademik vendos në dispozicion një fond i cili shërben kryesisht për mbështetjen dhe nxitjen e publikimeve dhe aktivitetit shkencor të stafit, zhvillimin e procesit mësimor dhe mbështetjen e punës kërkimore të studentëve. <i>Evidenca nr. 106: Rregullorja për punësimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës së stafit</i> <i>Evidenca nr. 61: Praktika e Mbështetjes së Pjesëmarrjes në Konferenca nga KU "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 78: Projekt Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari", tregon një strukturë të qëndrueshme dhe të menduar mirë për integrimin e komponentit kërkimor në nivelin e ciklit të dytë të studimeve. Përmes përfshirjes së lëndëve metodologjike dhe kërkesës për realizimin e tezës, programi u jep studentëve mundësinë për të zhvilluar aftësi kërkimore në përputhje me objektivat formues dhe standardet akademike.</i> <i>Njësia bazë mban një qasje që respekton lirinë akademike të stafit dhe e mbështet përfshirjen e tij në fusha të ndryshme studimore dhe kërkimore, duke nxitur edhe angazhimin e studentëve në projekte individuale. Megjithatë, për një orientim më të fortë drejt zhvillimit të kapaciteteve shkencore, është e nevojshme të konsolidohen më tej praktikatat që lidhen me përfshirjen e studentëve në aktivitete kërkimore jashtë kurikulës standarde, si dhe të krijohen mekanizma të qartë dhe të qëndrueshëm për mbështetjen financiare të kërkimit. Pavarësisht se programi përfiton nga një mbështetje bazë institucionale, mungesa e fondeve të dedikuara specifikisht për kërkimin mbetet një aspekt që mund të përmirësohet. Rekomandohet ndërtimi i një strategjie më të strukturuar kërkimore në nivel njësie, në përputhje me objektivat institucionale dhe zhvillimet bashkëkohore të fushës së komunikimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Njësia përgjegjëse e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” tregon përkushtim në ruajtjen e një profili akademik që mbështet zhvillimin e njohurive të avancuara dhe nxitjen e kërkimit shkencor. Evidentohet një përpjekje për të krijuar hapësira për projekte kërkimore, veçanërisht në përgatitjen e tezave dhe në përfshirjen e tematikave bashkëkohore në lëndët e ciklit të dytë. Kjo përbën një bazë të mirë për përmbushjen e objektivave të kërkimit të parashikuara në këtë nivel studimi. <i>Evidenca nr. 103: Rregullorja mbi Projektet Kërkimore Shkencore</i> <i>Evidenca nr. 67: Shkresa për organizimin e Konferencës së 3-të Ndërkombëtare për Studimet e Komunikimit dhe Medias</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit si njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi shfaq angazhim për të kontribuar në analiza dhe projekte me karakter kërkimor e aplikativ, të cilat lidhen me fushat e gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun. Në program përfshihen tematika bashkëkohore, çështje të komunikimit strategjik, etikës mediatike, digjitalizimit dhe ndikimit të teknologjive të reja në informim, të cilat përbëjnë fusha potenciale për analiza të thelluara akademike. Ka një përpjekje për përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në projekte kërkimore dhe aktiviteti ekstra kurrikulare, në borde shkencore të konferencave dhe revistave shkencore. <i>Evidenca nr. 53: Plani i Aktiviteteve të Departamentit të Shkencave të Komunikimit për vitin 2022-2023</i> https://bjh.beder.edu.al/https://iccms.beder.edu.al/pages.php?id=3
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Njësia përgjegjëse për këtë program studimi ka treguar angazhim në organizimin e aktiviteteve akademike si leksione të hapura, diskutime tematike dhe prezantime projektsh, të cilat kontribuojnë në krijimin e një mjedisi stimulues për studentët dhe stafin akademik. Departamenti gjithashtu realizon periodikisht konferencën shkencore ndërkombëtare (ICCMS) dhe konferencën e përvitshme studentore. Këto aktivitete ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësive profesionale, si dhe në përfshirjen në tematika aktuale të fushës së komunikimit.

	<i>Evidenca nr. 67: Shkresa për organizimin e Konferencës së 3-të Ndërkombëtare për Studimet e Komunikimit dhe Medias</i> <i>Evidenca nr. 75: Programi i Konferencës Studentore dhe lista e studentëve pjesëmarrës</i> <i>Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024</i> https://bjh.beder.edu.al/
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi”, me profile, ka një përmbajtje të mirëstrukturuar teorike dhe praktike që kontribuon në formimin e profesionistëve të aftë për të konkurruar në tregun e punës, veçanërisht në nivel kombëtar. Lëndët që trajtojnë komunikimin strategjik, marrëdhëniet me publikun, etikën mediatike dhe shkrimin profesional ndihmojnë në përvetësimin e aftësive të aplikueshme në një gamë të gjerë institucionesh dhe organizatash. Përfshirja e elementeve praktike si seminarët, projektet e komunikimit, prezantimet mediatike dhe trajtimi i rasteve konkrete është një aspekt pozitiv që e afron programin me realitetin profesional. Gjithashtu, prania e një teze finale ndihmon studentët të demonstrojnë kompetenca të avancuara në analizën e çështjeve të komunikimit <i>Evidenca nr. 41: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për Programi i Studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi”, me profile.
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian, por nuk përfshihet në profesionet e rregulluara.

ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive</i> , 2005/36/EU).				
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" reflekton një përpjekje të dukshme për të ofruar njohuri të avancuara teorike dhe praktike në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet në fushën e komunikimit.</i> <i>Njësia përgjegjëse mbështet aktivitetet kërkimore në mënyrë të moderuar dhe inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte studimore dhe punime diplome me karakter analitik e aplikativ. Megjithatë, dimensionimi i kërkimit shkencor formal dhe ndërkombëtarizimit është ende në zhvillim dhe kërkon më shumë mbështetje institucionale, si dhe përfshirje në rrjete akademike dhe projekte bashkëpunuese ndërkombëtare.</i> <i>Organizimi i aktiviteteve akademike (workshope, tryeza diskutimi) është i pranishëm, por duhet të zgjerohet në formate më të strukturuar si konferenca shkencore, me qëllim rritjen e profilit të kërkimit dhe ekspozimit të stafit dhe studentëve ndaj komunitetit shkencor më të gjerë.</i> <i>Për sa i përket përgatitjes për tregun e punës, programi arrin të formojë profesionistë të aftë për të konkurruar në nivel kombëtar dhe, në masë më të kufizuar, edhe ndërkombëtar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profile ofron një shumëllojshmëri formash të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përshtatura për nivelin e ciklit të dytë, ku përfshihen leksionet teorike, seminarët, projektet individuale apo në grup, prezantimet orale dhe detyrat me karakter kërkimor (ese, analiza, punime semestrale). Në disa lëndë është e dukshme përpjekja për të nxitur diskutimin, përfshirjen aktive të studentëve dhe aplikimin e njohurive në kontekste praktike përmes studimeve të rasteve, simulimeve dhe rasteve mediatike reale, çka përputhet me filozofinë e të nxënies me në qendër studentin. <i>Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në programin “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi”, me profile vërehet një përpjekje për të adresuar diversitetin e nevojave dhe stileve të të nxënies të studentëve. Personeli akademik, në pjesën më të madhe, aplikon metoda të kombinuara mësimdhënieje që përfshijnë prezantime teorike, diskutime interaktive, detyra praktike dhe projekte kërkimore, duke krijuar kështu hapësira për përfshirjen e studentëve me prirje dhe ritme të ndryshme të të nxënies. Përveç leksioneve klasike, përdoren platforma digjitale, materiale multimediale (Google Classroom, sistemi BIS etj.), konsultime individuale, mësim në distancë, si dhe forma të fleksibla të angazhimit në punë praktike dhe diskutime. Disa lektorë përdorin forma alternative vlerësimi si ese, projekte dhe prezantime, përtej provimeve tradicionale, çka ndihmon në krijimin e një ambienti mësimor më gjithëpërfshirës. Gjithashtu, evidentohet gatishmëri për komunikim të hapur me studentët, konsultime individuale dhe fleksibilitet në trajtimin e nevojave akademike apo administrative të tyre.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe	Institucioni tregon përkushtim në mbështetjen e personelit akademik për zhvillimin e kompetencave didaktike, duke zhvilluar trajnime të ndryshme si dhe angazhon lektorët në shkëmbimet Erasmus+ gjë e cila i ndihmon ata në përmirësimin e punës së tyre. Disa aktivitete si trajnime të organizuara brenda

në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	institucionit ose pjesëmarrje në konferenca dhe workshop-e të jashtme, ndihmojnë stafin akademik të përmirësojë aftësitë e tyre pedagogjike dhe të përshtatin metodat mësimore sipas zhvillimeve moderne. Qëllimi i kësaj qasjeje është të rrisë cilësinë akademike, duke siguruar që metodat e mësimdhënies të jenë vazhdimisht të harmonizuara me nevojat e studentëve dhe objektivat e përcaktuara të programit të studimit. <i>Evidenca nr. 39: Lista e Trajnimeve të Organizuara për Stafin gjatë viteve 2020-2024</i> <i>Evidenca nr. 81: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara EMI</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Bazuar në Evidencën 20 vërejmë se personeli akademik i angazhuar në program është përgjithësisht kompetent dhe i përgatitur në përmbushjen e rolit të mësimdhënies, duke shpjeguar qartë njohuritë dhe konceptet thelbësore të fushës së komunikimit. Metodatat e përdorura shpesh përfshijnë diskutime interaktive, punë në grupe dhe stimuj për mendim kritik dhe krijues, të cilat promovojnë autonominë dhe përgjegjshmërinë e studentëve gjatë procesit të të nxënit. Gjithashtu, vërehet një përkushtim i dukshëm për të ndërtuar marrëdhënie të respektit dhe bashkëpunimit mes stafit dhe studentëve, gjë që krijon një ambient të favorshëm për zhvillimin akademik dhe personal të studentëve. <i>Evidenca nr. 20: CV-të e Stafit Akademik të Angazhuar në Programin e Studimit</i> <i>Evidenca nr. 68: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore</i> <i>Evidenca nr. 116: Udhëzim mbi mësimdhënien në KU Bedër</i> <i>Evidenca nr. 84: Syllabus-et e lëndëve të programit</i> <i>Evidenca nr. 53: Plani i Aktiviteteve të Departamentit të Shkencave të Komunikimit për vitin 2022-2023</i> <i>Evidenca nr. 85: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, Viti Akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit tregon angazhim për vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të formave dhe metodave të mësimdhënies. Procesi përfshin mbledhjen e feedback-ut nga studentët përmes anketave, takimeve

studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	dhe konsultimeve, gjë që ndihmon në identifikimin e sfidave dhe mundësive për avancim. Ky mekanizëm i përfshirjes së studentëve është një praktikë e mirë dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke siguruar që metodat të përshtaten me nevojat dhe pritshmëritë e tyre. <i>Evidenca nr. 24: Formulari i vetëvlerësimit për Stafin Akademik</i> <i>Evidenca nr. 83: Raport Përmbledhës Vlerësimi i Departamentit për Stafin Akademik</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka krijuar struktura dhe njësi në nivel institucional që janë të dedikuara për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe koordinimin me njësitë bazë të studimit. Këto struktura mbështesin jo vetëm monitorimin dhe vlerësimin, por edhe eksperimentimin me metoda të reja dhe inovative në procesin mësimor. Të tilla janë Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si edhe Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, të cilat promovojnë dhe mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Këto struktura luajnë një rol kyç në koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të mësimdhënies mes njërive kryesore/bazë të programit të studimit, duke siguruar që përmirësimi i cilësisë të jetë i vazhdueshëm dhe i strukturuar. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise https://csdi.beder.edu.al/
Konkluzione	<i>Kolegji Universitar "Bedër" ka krijuar një ambient të përshtatshëm për realizimin e procesit të të nxënies dhe aftësimit profesional me metoda të ndryshme mësimdhënies që vënë në qendër studentin dhe promovojnë arritjen e rezultateve të pritshme. Personeli akademik është përgjithësisht kompetent dhe i përkushtuar për të përdorur forma interaktive të mësimdhënies, duke nxitur mendimin kritik dhe krijues të studentëve, si dhe duke krijuar marrëdhënie të respektit dhe bashkëpunimit.</i> <i>Mbështetja institucionale për zhvillimin e kompetencave didaktike të stafit ekziston, por do të përfitohej nga një organizim më i</i>



	<i>strukturuar dhe sistematik i trajnimeve dhe përmirësimeve pedagogjike. Përmirësimi dhe adaptimi i metodave të mësimdhënies nëpërmjet përfshirjes së studentëve në procesin e vlerësimit është praktikë pozitive, që mund të forcohet përmes formalizimit dhe dokumentimit të mëtejshëm.</i> <i>Strukturat dhe njësitë institucionale që promovojnë zhvillimin dhe inovacionin në mësimdhënie janë një shtyllë e rëndësishme e politikave të cilësisë, por rekomandohet rritja e transparencës dhe komunikimit të punës së tyre për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet personelit dhe studentëve.</i> <i>Në përgjithësi, programi dhe institucioni janë në rrugën e duhur për të siguruar një proces të mësimdhënies efektiv dhe gjithëpërfshirës, duke ofruar mundësi për zhvillim akademik dhe profesional të studentëve, me hapësira për përmirësim të mëtejshëm në aspektin e metodave dhe trajnimeve të stafit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore janë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe transparente në Rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret institucionale të posaçme. Këto dokumente janë të disponueshme dhe studentët njihen me to në fillim të procesit studimor, duke garantuar kështu transparencë dhe njohje të paracaktuar të kërkesave për arritjen e rezultateve të pritshme. Publikimi dhe njohja e këtyre rregullave janë elementë të rëndësishëm për sigurimin e drejtësisë dhe standardeve të njëjta për të gjithë studentët. Megjithatë, është e rëndësishme që njësi përgjegjëse të monitorojë vazhdimisht zbatimin e tyre në praktikë dhe të sigurojë që studentët të kenë mundësi të qarta për t'u orientuar mbi procesin e vlerësimit gjatë gjithë periudhës studimore.

	<i>Evidenca nr. 28: Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 48: Model kontrate me Studentin</i> <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i> <i>Evidenca nr. 96: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë</i> <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	GVJ në takimin me studentët shtroi pyetje në lidhje me informacionin që ata zotëronin mbi lëndët e ndjekura. Studentët na informuan se në fillim të çdo lënde ose moduli, ata informohen në mënyrë të detajuar nga titullari i lëndës/modulit për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore. Kjo praktikë siguron që studentët të jenë të vetëdijshëm për mënyrën se si do të vlerësohen gjatë kursit, përfshirë llojet e detyrave, kriteret e vlerësimit dhe peshën e tyre në notën përfundimtare. Informimi në këtë fazë është i domosdoshëm për të ndihmuar studentët në organizimin e përgatitjeve dhe për t'i përfshirë aktivisht në procesin mësimor dhe të vlerësimit. Për më tepër, kjo qasje promovon transparencën dhe drejtësinë në procesin arsimor. <i>Evidenca nr. 84: Syllabus-et e lëndëve të programit</i> https://www.beder.edu.al/programet/master-i-shkencave-ne-shkenca-komunikimi-profil-gazetari https://www.beder.edu.al/programet/master-i-shkencave-ne-shkenca-komunikimi-profil-marredhenie-publike
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në mënyra dhe forma të ndryshme, duke përfshirë provime me shkrim, gojore, detyra praktike, ese, projekte, prezantime dhe vlerësime gjatë praktikave profesionale. Kjo qasje e shumëllojshme i jep mundësi studentëve të demonstrojnë kompetencat e tyre në mënyra të ndryshme, duke respektuar stile dhe ritme të ndryshme të mësimnxënies. Përdorimi i metodave të ndryshme të vlerësimit kontribuon në një vlerësim më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të njohurive dhe aftësive profesionale, duke stimuluar përfshirjen aktive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive të tyre të ndryshme.




	Shtojca: Tabela nr. 15: Format e kontrollit te njohurive			
Konkluzione	<i>Procesi i testimit dhe vlerësimit në programin “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi” me profile, është i strukturuar, transparent dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike, duke garantuar një vlerësim të drejtë dhe gjithëpërfshirës të njohurive, aftësive dhe kompetencave të studentëve.</i> <i>Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit janë të dokumentuara dhe të publikueshme, duke u bërë të njohura për studentët që në fillim të procesit studimor.</i> <i>Informimi i studentëve nga titullarët e lëndëve për metodologjinë e vlerësimit është i mirëorganizuar dhe sistematik, duke garantuar transparencë dhe orientim të qartë gjatë gjithë periudhës së studimeve.</i> <i>Testimi dhe vlerësimi zhvillohet në forma të ndryshme, të përshtatura me natyrën e njohurive dhe aftësive që synohen, duke i dhënë mundësi studentëve të demonstrojnë në mënyra të ndryshme njohuritë e tyre dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik, duke përfshirë prova të ndryshme, detyra, prezantime dhe aktivitete të tjera mësimore, siç është përcaktuar qartë në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari përkatës. Kjo qasje garanton që vlerësimi përfundimtar të jetë një reflektim i drejtë dhe gjithëpërfshirës i performancës së studentit gjatë gjithë periudhës studimore, duke shmangur ndikimin e vetëm një provimi të vetëm. Transparenca e këtij procesi dhe përcaktimi i qartë i mënyrës së vlerësimit në syllabuse siguron që studentët të jenë të informuar

	dhe të përgatitur për kërkesat e çdo lënde/moduli, duke kontribuar në drejtësi dhe meritokraci në vlerësim. <i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KU "Bedër" ka adoptuar dhe përdor sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat kontribuojnë në rritjen e transparencës dhe ndershmërisë së procesit arsimor. Përdorimi i këtyre sistemeve ndihmon në minimizimin e mundësive për abuzim, manipulim apo keqinterpretim të rezultateve, duke siguruar një mjedis më të besueshëm dhe të drejtë për studentët. Sistemet elektronike gjithashtu ofrojnë mundësi për regjistrimin dhe ruajtjen e rezultateve në mënyrë të qëndrueshme dhe lehtë të aksesueshme, duke lehtësuar monitorimin dhe verifikimin e vlerësimeve. https://bis.beder.edu.al/ https://pds.beder.edu.al/
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i çdo lënde/moduli kryhet në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në syllabusin përkatës dhe në bazën ligjore në fuqi. Kjo siguron që procesi i vlerësimit është i standardizuar, i drejtë dhe i përputhshëm me rregulloret institucionale dhe ligjore, duke garantuar transparencë dhe besueshmëri. Respektimi i këtyre kriterëve ndihmon në sigurimin e një procesi vlerësimi që mbron të drejtat e studentëve dhe siguron që rezultatet përputhen me performancën reale akademike. <i>Evidenca nr. 112: Shembull Syllabusi</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale nuk kufizohet vetëm në dhënien e notës përfundimtare, por shoqërohet edhe me komente dhe feedback konstruktiv, kur kjo është e nevojshme. Kjo qasje ndihmon studentët të kuptojnë më mirë pikat e tyre të forta dhe ato ku kanë nevojë për përmirësim, duke e bërë procesin e vlerësimit më të dobishëm dhe edukativ. Përfshirja e këshillave mbi procesin e të nxënit i mundëson studentit të marrë hapa konkretë për zhvillimin personal dhe

	akademik, duke promovuar një kulturë mësimi të vazhdueshëm dhe autonomi në të nxënit. <i>Evidenca nr. 111: Shembull i çelësit të tezës së provimit</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në programin “Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi, njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik zbatojnë politika dhe procedura të qarta dhe strikte për parandalimin e plagjiaturës, kopjimit në provime dhe çdo forme tjetër të sjelljes joetike akademike. Kjo përfshin përdorimin e mjeteve teknologjike dhe platformave si PlagiarismSearch, për kontrollin e punimeve dhe aplikimin e masave disiplinore kur konstatohet shkelja. Kultura akademike e ndershmërisë dhe integritetit është thelbësore për besueshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë dhe për vlerësimin real të aftësive dhe dijeve të studentëve. https://pds.beder.edu.al <i>Evidenca nr. 84: Syllabus-et e lëndëve të programit</i> <i>Evidenca nr. 28: Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 95: Rregullorja e Disiplinës së Studentëve të Kolegjit Universitar “Bedër”</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritën reale të studentëve dhe jepen brenda afateve të përcaktuara në rregulloret institucionale. Kjo praktikë garanton drejtësi dhe transparencë në vlerësimin akademik, duke siguruar që studentët të marrin një reflektim të drejtë të performancës së tyre. Respektimi i afateve për dhënien e rezultateve ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të studimeve nga ana e studentëve dhe promovon besimin në sistemin arsimor. <i>Evidenca nr. 30: Kalendar Akademik “Master”</i> <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në	Institucioni siguron të drejtat e studentëve për t’u njohur në mënyrë të plotë dhe transparente me procesin e vlerësimit dhe rezultatet e tij. Gjithashtu, garanton mundësinë për kërkesën e rishikimit të vlerësimit në përputhje me rregullat e përcaktuara në statut, rregulloret dhe procedurat përkatëse.

statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Kjo qasje mbështet parimin e drejtësisë dhe transparencës në sistemin arsimor, duke i ofruar studentëve një mekanizëm të besueshëm për të adresuar shqetësimet apo paqartësitë lidhur me vlerësimin. <i>Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit "Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i> <i>Evidenca nr. 64: Praktika e një rasti ankimimi note</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Institucioni ka përcaktuar procedura të qarta dhe transparente për shqyrtimin e kërkesave dhe ankimeve të studentëve lidhur me vlerësimin. Këto kërkesa trajtohen nga një komision, i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre vetash, të cilët kanë për detyrë të sigurojnë një analizë të drejtë dhe objektive të kërkesës. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Procesi është i dokumentuar dhe arkivohet në mënyrë rigoroze, duke siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri për të gjitha palët e përfshira. Kjo praktikë garanton një sistem efikas dhe të drejtë të trajtimit të ankesave, duke rritur besimin e studentëve në procesin e vlerësimit dhe në institucion si tërësi. <i>Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 66: Procedura për ankimin notës</i>
Konkluzione	<i>Institucioni garanton një proces të drejtë, transparent dhe të besueshëm të vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve. Kriteret dhe metodat e vlerësimit janë të qarta, publike dhe të njohura nga studentët, duke u informuar në fillim të çdo lënde për mënyrën e testimit dhe vlerësimit.</i> <i>Zbatimi i sistemeve elektronike për testim dhe vlerësim është një hap i rëndësishëm drejt reduktimit të rasteve të abuzimit dhe rritjes së transparencës së procesit.</i> <i>Personeli akademik dhe njësitë përgjegjëse zbatojnë masa të forta për parandalimin e plagjiaturës dhe sjelljeve joetike, duke garantuar integritetin akademik.</i>

	<i>Rezultatet e vlerësimeve bazohen në meritë dhe publikohen në kohë, ndërsa studentët kanë të garantuar të drejtën për t'u njohur me vlerësimin e tyre dhe për të kërkuar rishikim nëpërmjet procedurave transparente dhe të dokumentuara.</i> <i>Sistemi i ankimimit është i organizuar mirë, me komisione të posaçme që trajtojnë kërkesat dhe ankesat në mënyrë profesionale, duke siguruar drejtësi dhe besueshmëri në procesin e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”, “Gazetari” është strukturuar në mënyrë që të sigurojë thellimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve në fushën përkatëse të studimeve. Ai promovon zhvillimin e aftësive profesionale dhe kompetencave shkencore të nevojshme për të përballuar sfidat e tregut të punës dhe kërkesat e zhvillimit akademik. Përmes moduleve të specializuara, projekteve kërkimore dhe aktiviteteve praktike, studenti nxitet të zhvillojë aftësi të avancuara krijuese dhe zbatuese, të cilat janë thelbësore për një performancë profesionale të suksesshme dhe zhvillim të qëndrueshëm në karrierë. <i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit “Master i shkencave” në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit përmban module dhe aktivitete që sigurojnë zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushat e teknologjisë së informacionit, shkencave humane dhe sociale, si dhe në komunikim dhe ndërveprim. Në mënyrë të veçantë, përfshirja e mësimi të gjuhëve të huaja kontribuon në rritjen e kapaciteteve ndërkulturore dhe

	ndërkombëtare të studentëve, duke i përgatitur ata për sfidat e një tregu pune gjithnjë e më global dhe dinamik. Ky fokus i programit garanton që studentët të jenë të pajisur me kompetencat e nevojshme për të komunikuar dhe bashkëpunuar efektivisht në një mjedis profesional dhe social të larmishëm. <i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi i studimit dhe syllabuset për secilën lëndë përmbajnë qartë kompetencat dhe aftësitë që studentët duhet të fitojnë gjatë zhvillimit të kursit. Në përfundim të çdo lënde, personeli akademik analizon dhe shqyrtojnë së bashku me studentët arritjet kryesore, duke theksuar aspektet më të rëndësishme të përmbajtjes dhe duke dhënë udhëzime konkrete për zbatimin praktik të njohurive të fituara. Ky proces mbështet një qasje të mirëstrukturuar për reflektimin mbi përmbajtjen dhe përgatitjen e studentëve për detyrimet përmbyllëse, duke kontribuar kështu në një mësimdhënie cilësore dhe orientuar drejt rezultateve të matshme të të nxënit. <i>Evidenca nr. 11: Anketa e studentit për pedagogun dhe lëndën</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e	Mësimdhënia në këtë program të studimit zhvillohet mbi bazën e kompetencave të përcaktuara qartë, duke i mundësuar studentëve të aplikojnë njohuritë teorike në situata praktike përmes laboratorëve dhe praktikave profesionale. Personeli akademik promovon aktivisht diskutimet dhe punën në grup, duke krijuar një ambient stimulues për zhvillimin e mendimit kritik dhe zgjidhjen kreative të problemeve. Gjithashtu, mbështetja e ideve inovative dhe angazhimi në studime kërkimore e shkencore të avancuara nxisin zhvillimin profesional dhe intelektual të studentëve. Përveç kësaj, bashkëpunimi me institucione partnerë dhe nxitja e mobilitetit studentor përbëjnë një dimension të rëndësishëm për zgjerimin e perspektivave akademike dhe profesionale të studentëve. <i>Evidenca nr. 44: Marrëveshje mobiliteti Erasmus +</i>

mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<i>Evidenca nr. 34: Kurrikula e Programit të studimit "Master i shkencave" në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike"</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik i angazhuar në program është aktiv dhe efektiv në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve, ku trajtohen zhvillimet më të fundit në shkencë dhe teknologji. Këto aktivitete mbështesin përditësimin e njohurive të studentëve dhe nxisin debatet kritike mbi temat bashkëkohore, duke i lidhur njohuritë teorike me praktikën dhe zhvillimet aktuale në fushën e komunikimit, gazetarisë dhe marrëdhënieve publike. Gjithashtu, përfshirja e këtyre seminareve brenda dhe jashtë programit formal të studimit kontribuon në përgatitjen e studentëve për kërkime të thelluara dhe për sfidat profesionale, duke rritur cilësinë dhe konkurrencën e tyre në tregun e punës. <i>Evidenca nr. 87: Plani i Aktiviteteve të Departamentit, 2024-2025</i> <i>Evidenca nr. 35: Leksione të Hapura me ekspertë të mediave, gazetarisë dhe marrëdhënieve me publikun</i> <i>Evidenca nr. 81: Raport mbi Trajnimet e Zhvilluara EMI</i> https://www.beder.edu.al/aktivitete/sistem-et-e-shperndara-procesimi-dhe-komunikimi-midis-tyre-1
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni tregon angazhim të dukshëm në nxitjen e zhvillimit të ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore nga studentët. Përmes strukturave mbështetëse, studentët inkurajohen të përfshihen në projekte kërkimore që zgjasin përtej kuadrit të mësimit të zakonshëm, duke zhvilluar aftësi të pavarura kërkimore dhe kreative. Kjo qasje promovon një kulturë kërkimore të fuqishme dhe forcon përgatitjen shkencore të studentëve për karrierën akademike dhe profesionale. Mbështetja financiare dhe organizative e institucioneve ndihmon në realizimin e këtyre projekteve, duke i dhënë mundësi studentëve të përballen me sfida reale kërkimore, të përdorin burime të avancuara dhe të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive në fushën e tyre. Ky angazhim reflektuar në rezultatet e studentëve është një tregues i fortë i cilësisë dhe inovacionit në programin e studimit. https://facebook.com/share/p/1HH1MawUZ3/ <i>Evidenca nr. 19: Çmimi për konferencën studentore</i>

Konkluzione	<i>Institucioni tregon një angazhim të qartë dhe të qëndrueshëm në nxitjen dhe mbështetjen financiare të ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore nga studentët.</i> <i>Mbështetja e dhënë për kërkimin studentor është e organizuar dhe ofron mundësi reale për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe kreative, duke përmirësuar cilësinë e procesit mësimor dhe përgatitjen profesionale të studentëve.</i> <i>Ky fokus i institucionalizuar në kërkimin shkencor ndër studentë është një element pozitiv që i jep programit një dimension konkurrues dhe përgatit studentët për sfidat e tregut të punës dhe studimeve të mëtejshme.</i> <i>Në përgjithësi, programi i studimit është i dizajnuar për të garantuar që studentët të fitojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për t'u angazhuar në fusha të ndryshme profesionale, duke i mundësuar atyre të adaptohen dhe të kenë sukses në një mjedis gjithnjë e më të teknologjizuar dhe të ndryshueshëm.</i> <i>Rekomandohet të vazhdohet fuqizimi i këtyre mekanizmave mbështetës për të përfshirë edhe më shumë studentë dhe për të zgjeruar gamën e projekteve kërkimore të financuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar dhe zbatuar një procedurë të qartë dhe të detajuar për detyrimet përmbyllëse të studentëve në programin e studimit. Kjo procedurë përfshin të gjitha fazat para realizimit të detyrimeve përmbyllëse dhe garantohet që studentët informohen në mënyrë transparente dhe në kohë për procesin dhe dokumentacionin e nevojshëm. Procedura është bërë publike dhe është lehtësisht e aksesueshme për të gjithë studentët, duke siguruar kështu parimet e transparencës dhe drejtësisë në përfundimin e ciklit të studimit.
	<i>Evidenca nr. 2: Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar "Bedër"</i>

	Evidenca nr. 90: Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë Evidenca nr. 98: Rregullorja e Programit të Studimit "Master i shkencave në Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marrëdhënie publike" Evidenca nr. 41: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Në përputhje me kërkesën e këtij kriteri, struktura përgjegjëse dhe personeli akademik ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë periudhës së përgatitjes për detyrimet përmbyllëse. Kjo mbështetje siguron që studentët të kenë akses në informacionet dhe burimet e nevojshme për t'u përgatitur në mënyrë efikase dhe të suksesshme. Përmes ofrimit të udhëzimeve të qarta dhe materialeve të nevojshme, si dhe mbështetjes praktike dhe akademike, institucionet e mundësojnë që studentët të kenë të gjitha mjetet për të përmbushur detyrimet përmbyllëse. Kjo gjithashtu mundëson një kalim më të lehtë dhe të strukturuar nga periudha e mësimdhënies në atë të testimit dhe përfundimit të studimeve. Ky proces ofron transparencë dhe besueshmëri për studentët, duke u mundësuar atyre të arrijnë objektivat e përcaktuara në programin e studimit dhe të përfundojnë me sukses detyrimet përmbyllëse. Evidenca nr. 30: Manuali për përgatitjen së diplomës për studentët e ciklit të parë Evidenca nr. 19: Sylabusi i Lëndës "Punimi i Diplomës" Evidenca nr. 21: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final ndjek një qasje gjithëpërfshirëse në vlerësimin e studentëve, duke marrë parasysh njohuritë e fituara gjatë gjithë periudhës së studimeve. Vlerësimi i integruar i të gjitha lëndëve/modulëve, duke iu referuar rëndësisë dhe peshës së tyre relative, siguron një pasqyrë të saktë dhe të drejtë të arritjeve akademike të studentëve. Kjo metodologji garanton që vlerësimi final të jetë i balancuar dhe transparent, duke shmangur mbivlerësimin ose nënvlerësimin e njërës ose tjetrës komponentë të programit. Evidenca nr. 23: Formulari i vlerësimit në mbrojtjen e Tezës

Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Roli i personelit akademik, veçanërisht i udhëheqësit të punimit të diplomës, është thelbësor në orientimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë gjithë procesit të punimit përmbyllës. Udhëheqësi jo vetëm që ndihmon në zgjedhjen e temës, por edhe asiston në zhvillimin metodologjik, përpunimin e rezultateve dhe përgatitjen e punimit në përputhje me udhëzuesit dhe standardet akademike. Ky mbikëqyrje e garanton cilësinë e punimit dhe siguron që ai të plotësojë kriteret e kërkuara para paraqitjes për vlerësim nga komisioni. <i>Evidenca nr. 107: Udhëzuesi i Këshilltarit Akademik</i> <i>Evidenca nr. 74: Procesverbali i mbledhjes së komitetit shkencor të Departamentit për vlerësimin e propozimit të tezave</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni duhet të sigurojë mbështetje të plotë teknike dhe logjistike për studentët gjatë realizimit të matjeve, analizave dhe testeve që janë pjesë e punimeve përmbyllëse. Kjo përfshin aksesin në laboratorë, pajisje, softuerë, si dhe mundësi bashkëpunimi me institucione apo laboratorë jashtë institucionit në rastet kur kërkesat e temës e imponojnë këtë. Kjo mbështetje është e rëndësishme për të garantuar që studentët të kenë mundësi të zbatojnë me cilësi metodat dhe të sigurojnë rezultate të besueshme shkencore, duke i përgatitur për kërkimin profesional dhe punësimin në fushën e tyre. <i>Evidenca nr. 41: Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentët e Ciklit të Dytë</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Ky kriter është esencial për përfundimin e procesit të studimeve dhe përcaktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive të studentit. Vlerësimi përfundimtar i studentit, qoftë në bazë të provimit final apo mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të jetë i qartë, objektiv dhe transparent. Nota e dhënë reflekton nivelin e arritjeve akademike dhe cilësinë e punës së kryer, duke përfshirë njohuritë teorike, aftësitë praktike dhe përgatitjen kërkimore. Për më tepër, sistemi i vlerësimit duhet të jetë në përputhje me rregulloret institucionale dhe të respektojë kriteret e meritokracisë, duke siguruar që çdo student të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.

	<i>Evidenca nr. 51: Vendim i këshillit të departamentit për ngritjen e jurive të tezave</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit të studimeve, dhënia e diplomës dhe suplementit të saj të miratuar nga Ministria përgjegjëse është thelbësore për njohjen zyrtare të kualifikimit të fituar. Për më tepër, ofrimi i kopjes zyrtare dhe të plotë të programit të studimit i jep studentit një dokument të rëndësishëm që vërteton përmbajtjen dhe kurrikulën e ndjekur, duke mbështetur proceset e mëtejshme të punësimit apo studimeve të avancuara. <i>Evidenca nr. 21: Diploma dhe Suplementi</i> <i>Evidenca nr. 8: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni ka përgjegjësi ligjore dhe etike për të ruajtur në mënyrë të sigurt dhe të organizuar të gjithë dokumentacionin e studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe arkivimin. Ky kriteri është i domosdoshëm për të siguruar menaxhimin e duhur dhe të sigurt të të dhënave personale dhe akademike të studentëve. Ai garanton që informacioni mbi studentët të ruhet dhe mund të ofrohet në përputhje me kërkesat ligjore, duke respektuar të drejtat e studentëve për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu, duke siguruar aksesin e duhur dhe informimin e studentëve në rast kërkesash, institucioni nxit transparencën dhe besueshmërinë në raport me studentët dhe palët e tjera të interesuara. <i>Evidenca nr. 92: Rregullorja e Arkivës</i>
Konkluzione	<i>Në konkluzion mund të thuhet se KU "Beder" ka krijuar dhe zbatuar procedura të qarta dhe transparente për menaxhimin e detyrimeve përmbyllëse të studentëve, duke siguruar asistencë të vazhdueshme nga personeli akademik dhe strukturat përkatëse. Komisionet e administrimit të provimeve përfundimtare funksionojnë në përputhje me rregulloret dhe kriteret e përcaktuara, duke garantuar një vlerësim të drejtë dhe të balancuar. Procesi i udhëheqjes dhe mbështetjes së studentëve gjatë përgatitjes së punimit të diplomës është i mirëorganizuar dhe kontribuon në cilësinë e rezultateve akademike. Institucioni siguron edhe mbështetje teknike dhe materiale për realizimin e kërkimeve dhe analizave të nevojshme në kuadër të punimeve përmbyllëse. Dokumentacioni i studentëve ruhet me kujdes, duke</i>

	respektuar legjislacionin në fuqi, dhe studentët kanë akses në informacionet për Në konkluzion mund të thuhet se katëse sipas nevojës. Gjithashtu, në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomë dhe suplement sipas standardeve të miratuara, duke përmirësuar kështu formalitetet dhe transparencën e përfundimit të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari”. N/A
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfutimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari”. N/A
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e	Ky kriter nuk është i aplikueshëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari”. N/A

trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione	<i>Ky programi studimi përmbush me sukses standardet e kërkuara për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale. Njësia bazë siguron ambiente të përshtatshme dhe infrastrukturë bashkëkohore, duke ofruar mundësi të shumta për zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve. Bashkëpunimi me institucione partnere përforcon më tej cilësinë dhe rëndësinë profesionale të praktikave, duke garantuar përgatitje të mirëfilltë për tregun e punës dhe zhvillimin profesional të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik aktiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në	Nga analizimi i dokumentacionit të përcjellë nga KU BEDER Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” përmbushin kriteret ligjore për nivelin e kualifikimit për mbulimin e lëndëve dhe moduleve dhe eksperiencës në përputhje me këtë program studimi. Njësia bazë e programit të studimit, që është Departamenti i Shkencave të Komunikimit përcakton fushën e kompetencës dhe nivelit akademik të stafit si atyre PAE dhe PAK (në bashkëpunim

mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

me Rektoratin). Niveli i kualifikimit për stafin akademik që jep mësim në këtë program studimi është si me poshtë:

Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr	-	-	-	-	-	1
Prof. As. Dr	-	2	1	1	2	-
Dr.	6	-	5	-	5	-
MSc (asistentë)	1	-	1	-	1	-
Total	7	2	7	1	8	1

Evidenca 5. Rregullorja mbi organizimin administrativ

Evidenca 20. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

Evidenca nr. 90 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë

Evidenca nr. 96 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë

Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike

Evidenca Shtojca – Tabelat përmblledhëse. Tabela 7

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Mbështetur në dokumentacioni e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se KU BEDER kujdeset që personeli akademik efektiv të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit. Ngarkesa e pedagogeve është brenda normave të caktuara. Nga shikimi i tabelës ku paraqitet ngarkesa akademike e stafit për vitin akademik 2024-2025, lidhur me programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari” rezulton se rreth 95% ngarkesës mësimore orë në auditor mbulohet nga staf akademik efektiv/ i brendshëm PAE dhe 5% nga personeli me kontratë, PAK. Ky tregues ka qenë gjithnjë në favor të personelit akademik efektiv edhe për vitin akademik 2023-2024 dhe 2022-2023 duke mbuluar mbi 92% nga PAE dhe më pak se 8% nga PAK.

Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, gjatë vitit aktual mësimor

	2024-2025 ka 11 pedagogë efektivë, PAE, dhe 5 pedagogë PAK dhe një ndihmës akademik. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 12.1</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 1</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 6.3</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Nga analizimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionit të përcjellë nga KU Bedër, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vëren se personeli akademik ka treguar qëndrueshmëri, dhe kjo si në programin e studimit, ashtu edhe si personel i Departamentit. Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve njerëzore, GVJ u njoh me dosjen e plotë stafit të departamentit e cila përmban edhe kontratat e punës dhe mbulimin me sigurimet shoqërore. <i>Evidenca 20. CV e stafit akademik</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	KU Bedër ka hartuar proceduara të përcaktuara lidhur me menaxhimin e Burimeve Njerëzore, rekrutimin dhe vlerësimin e tij. Sipas “Procedurës së rekrutimit të stafit akademik” institucioni ka ngritur të ndërthuara hapat bazë për rekrutimin ashtu edhe procedurën që duhet ndjekur për lëvizjet e brendshme të stafit. Përzgjedhja e stafit fillon që me aplikimin me dosjen dhe më pas duke kaluar edhe në fazën e konkursit/intervistimit. Për stafin akademik që kërkohet me profile të veçanta, secili departament harton edhe kriteret specifike në varësi të nevojës që ka programi i studimit. <i>Evidenca nr. 70. Procedura e rekrutimit të stafit akademik</i> <i>Evidenca nr. 32 Kontrate pune individuale me kohe te plote e stafit akademik</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore,	Mbështetur në dokumentacioni e përcjellë nga institucioni, GVJ vëren se KU Bedër ka burime njerëzore edhe personel ndihmës akademik që është i mjaftueshëm për të realizuar programin mësimor Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi me profile. Edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ pati kontakt me personalin ndihmës që asiston në këtë program studimi, vizitoi laboratorët e Teknologjisë së Informacionit, sekretarinë mësimore, muzeun e shkencave të komunikimit dhe pa mjediset e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.

sipas natyrës specifike të programit të studimit.	<i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 1</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se KU Bedër, Zyra e Burimeve Njerëzore, ka mbledhur dhe ruajtur të dhënat e personelit akademik (me kohë të plotë apo të pjesshme PAE/ PAK) dhe administrativ të angazhuar me programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi me profilet: Gazetari dhe Marrëdhënie Publike”, duke i përmbledhur të gjitha informacionet në dosje individuale për stafin. Ngarkesa mësimore e stafit akademik, propozohet nga departamenti dhe me pas miratohet nga dekan i universitetit, duke u bazuar në udhëzimet përkatëse. Gjatë vizitës dhe takimit me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore u morën me përzgjedhje rastësore dosjet e personelit akademik të anëtarëve të personelit akademik të angazhuar me programin e studimit, si për staf Akademik PAE dhe PAK. GVJ konstaton se dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi arsimin, në të gjitha nivelet; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dosja përmban edhe vlerësimin që i është bërë pedagogut nga studentët; (v) Kontratat e punës në vite, etj. <i>Evidenca nr 68. Vendimi i Keshillit të Departamentit për Ngarkesën Mësimore.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni ka një listë të plotë të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis KU Bedër dhe institucioneve arsimore dhe jo arsimore që u krijojnë mundësi studentëve në realizimin e praktikave mësimore, si edhe në rritjen e mundësive për studentët. Për periudhën 2024-2026 KU Bedër ka marrëveshje në kuadër të programit Erasmus+ me disa universitete të huaja: ▪ “University of Applied Science Lavoslav Ruzicka” në Vukovar, Kroaci; ▪ West University of Timisoara, Rumani; ▪ Universidad de Pontificio de Salamanca. Gjithashtu universiteti është pjesë e networkut CEEPUS “Media in transition”.

	<i>Evidenca nr. 36 Marreveshjet e bashkepunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktore te biznesit vendas dhe te huaj</i> <i>Evidenca nr. 37 Lista e marreveshjeve institucionale dhe Erasmus plus</i> <i>Evidenca nr. 44 Marreveshje mobiliteti Erasmus +</i> <i>Evidenca nr. 69 Procedura e praktikës profesionale</i> <i>Evidenca nr. 73. Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfagesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i>			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, listat e bashkëpunimit me institucionet pritëse për realizimin e praktikave mësimore, këto institucione organizojnë mikpritjen e studentëve për realizimin e detyrave të tyre. <i>Evidenca nr. 73. Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfagesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 69. Procedura e Praktikës Profesionale</i>			
Konkluzione	GVJ, mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës, vlerëson se personeli akademik që mbulon programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi me profilet: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari", përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur profesional në përputhje me fushën e programit të studimit. KU Bedër ka marrëveshje mobiliteti dhe programe bashkëpunimi në kuadër të network me universitete të tjera të huaja. Institucioni ka procedura të rregullta rekrutimi, mbledh dhe ruan dokumentacionin mbi personelin akademik të përfshirë në programet e studimit. GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, institucioni ka mjediset të dedikuara këtij programi studimi dhe që janë në ndihmë të një procesi praktik të të mësuarit për studentët. Të tilla janë: newsroom, muzeu i medias dhe komunikimit, laborator i gjuhëve të huaja dhe kompjuterëve, etj. Në evidencën e paraqitur në dokumente e akreditimit, si shtojcë e raportit të vlerësimit të brendshëm, në tabelën 16, raportohet për një sipërfaqe totale prej 2732.5m² dhe bazuar në përlllogaritjet janë rreth 4.53 m²/ student. Nga vizita e GVJ në mjediset e reja të institucionit u vu re se klasat mjediset mësimore ishin të mjaftueshme, të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për zhvillimin e një orë interaktive mësimore. Ambientet ishin me hapësira të mjaftueshme, dhe komode për studentët. Të gjitha ambientet mësimore përshtateshin me numrin e studentëve që frekuentojnë programin. <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Mjediset e Fakultetit /Njësia bazë Tabela 16</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabelat përmbledhëse, Tabela 17</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita e GVJ në mjediset e institucionit u vu re se mjediset mësimore ishin të pajisura me mjetet teknologjike të nevojshme për zhvillimin e një orë mësimi interaktive. Në klasa kishte kompjutera, tabelë projektimi, tabela interaktive dhe internet. Këto mjediset, janë të gjitha të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm. KU Bedër ka një newsroom të veçantë që i shërben studentëve të këtij programi por mund të përdoret edhe nga departamentet e tjera. <i>Evidenca Shtojca – Tabela- Mjediset e Fakultetit /Njësia bazë Tabela 16</i> <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i>

Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vizita e GJVJ në mjediset e reja të institucionit dhe nga materialet e përcjella nga KU Bedër, atje ka mjedise mësimore, për studentët e këtij programi studimi dhe gjithë departamentit. Janë 128 kompjutera, Newsroom, si dhe një muze të medias dhe komunikimit, në të cilin studentët njihen më nga afër me pajisjet teknologjike të përdorura për komunikimin masiv, si dhe atyre më të reja. Të tilla mjedise u mundësojnë studentëve aftësimin praktik, përpos njohurive teorike që marrin nga programi në kuadër të përmbushjes së objektivave formues të programit të studimit në tërësi. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Studentët e këtij programi Master i Shkencave kanë në dispozicion dy laboratorë të kompjuterave në të cilët kanë qasje sipas nevojës, si edhe newsroom. Kompjuterat e këtij laboratorit ishin të pajisur më të gjithë programet e nevojshme që iu duhen studentëve të programit për të kryer detyrat e tyre praktike. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe	KU Bedër ka marrëveshje me institucione në mënyrë që studentët e këtij programi Master i Shkencave të zhvillojnë praktikën e tyre profesionale. Sipas dokumentacionit të përcjellë KU Bedër ka marrëveshje të lidhura të cilat janë aktive me 32 institucione dhe organizata. Afatet e këtyre marrëveshjeve janë të ndryshme por ka prej tyre me afatet më të gjatë se 5-vjeçare dhe/ose që përtërihen vit pas viti. Midis këtyre renditen organizata mediatike, organizma të shoqërisë civile dhe biznese të tjera. Këto institucione janë mjaft të konsoliduara dhe me eksperiencë të gjatë në fushën e medias si Instituti Shqiptar i Medias (me afat deri në 2029) apo edhe biznese mediatike të rëndësishme në treg si Iceberg Communication, New Media Communication, New Media Digital, Protik Albania, etj. Sipas dokumentit të praktikës profesionale janë të përcaktuar qartësisht edhe hapat që ndiqen nga studenti dhe mbështetja që i jep departamenti dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës në këtë

ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	proces. Hapi i fundit është ndërtimi i një raporti nga studenti për ecurinë e praktikës si edhe marrja e një formatoi vlerësimi nga institucioni ku është zhvilluar praktika. Të dy këto dokumente paraqiten në departament dhe pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës. <i>Evidenca nr. 36 Marreveshjet e bashkepunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktore te biznesit vendas dhe te huaj</i> <i>Evidenca nr. 69 Procedura e praktikës profesionale</i> <i>Evidenca nr. 73. Vendimi i Keshillit te Departamentit per Percaktimin e Perfagesuesit prane Zyres se Planifikimit te Karrieres</i>			
Konkluzione	GVJ thekson se KU Bedër vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme me salla, laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe mjedise të tjera mësimore për realizimin e procesit mësimdhënës në këtë program studimi. Nga lista e organizatave dhe bizneseve me të cilat KU Beder ka lidhur marrëveshje janë 32 institucione mjaft të rëndësishme mediatike në vend.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ vëren se institucioni garanton akses për studentët në bibliotekën mësimore dhe garanton shfrytëzimi të barabartë të mundësive të saj, për studentët e programit. Nga vizita e grupit të vlerësimit në bibliotekën mësimore u pa se institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise të mjaftueshme për këtë qëllim. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe një fond librash fizik të konsiderueshëm. Gjithashtu biblioteka ka rregulla të qarta, orare të mirëpërcaktuara dhe ishte e pajisur me kompjuterë, ku studentët mund të bëjnë edhe kërkime online apo në fondin elektronik të institucionit.

	KU Bedër ka edhe marrëveshje me platformën JSTOR për një shfrytëzim më të gjerë të literaturës në ndihmë të programeve të studimit. Aksesit në këtë platformë është falas për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidenca nr. 42 Marrëveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 65 Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Shkencave të Komunikimit e ka pjesë të praktikës së tij diskutimin për syllabuset e lëndëve dhe kjo bëhet çdo fillim viti. Pjesë e diskutimeve janë edhe literatura bazë, e detyrueshme si edhe ajo me zgjedhje për lëndët mësimore. <i>Evidenca nr. 46 Mbledhje e Keshillit të Departamentit për diskutimin e sylabuseve</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Pjesë e fondit të bibliotekës janë pothuajse të gjithë titujt e literaturës së detyrueshme. Fondi i bibliotekës pasurohet vazhdimisht edhe me prurje të reja nga donacionet që KU Bedër ka lidhur me institucione . <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka përmban një fond prej 22.600 titujsh, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore. Abonimi në platformën JSTOR krijon akses të mbi 12 milionë artikuj të revistave shkencore. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka edhe abonime specifike që lidhen tek revistat Business Magazine dhe gjithashtu zotëron revistën “Objektiv”. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në	Të gjithë studentët dhe anëtarët e stafit të KU Bedër kanë akses pa pagesë në platformën JSTORE. Aksesit realizohet nëpërmjet email personal në KU Bedër dhe aty mund të kërkohen lexohen dhe shkarkohen artikujt e ndryshëm.

bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka e KU Bedër mundëson aksesin edhe në Book Academic Collection.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e KU Bedër ka kompjuterë që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e funksionimit të bibliotekës janë 8:30-19:00. Sikurse përshkruhet në RVB, në periudhën e provimeve biblioteka qëndron e hapur edhe në fundjavë. Oraret e funksionimit të bibliotekës janë të publikuara dukshëm për studentët.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Mënyrat për pasurimin e bibliotekës në KU Bedër janë të ndryshme. Fondet për blerjen e librave dhe pasurimin e bibliotekës janë të parashikuara në buxhetin e departamenteve. Në konsultim me lektorët e lëndëve specifike, departamentet dërgojnë kërkesat për literaturën e nevojshme. Në KU Bedër biblioteka është pasuruar nga dhurimet e 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë dhe nga Instituti Shqiptar i Medias në kuadër të projektit të Edukimit Mediatik të Universiteteve. Ndërsa vetë studentët e KU Bedër në kanë realizuar një projekt për mbledhjen e librave si pjesë e një lënde “Konceptim dhe Menaxhim Fushate”. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të dhëna të plota për platformat online / Struktura e Teknologjisë së informacionit / Biblioteka / Biblioteka online, etj, Tabela 17</i> <i>Evidenca nr. 42 Marreveshja për akses në JSTOR</i> <i>Evidenca nr. 31 Liste librash të dhuruara nga Instituti Shqiptar i Medias</i>
Konkluzione	<i>GVJ duke parë dokumentacionin e përcjellë nga institucioni, dhe pas vizitës vëren se KU Bedër ka një bazë fizike të librave që mbështesin literaturën e nevojshme për lëndët e zhvilluar në programin mësimor. Kjo literaturë dhe bazë fizike e librave</i>

	<i>përditësohet në mbështetje të mësimdhënies. Gjithashtu institucioni ofron falas për stafin dhe studentët platformën online JSTOR për të shfletuar dhe download libra dhe artikuj shkencorë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionit të mbledhur gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se institucioni përdor sistemin/programin BIS (Bedër Information System). Ky sistem bën të mundur ruajtjen e të gjithë të dhënave të studentëve, përgjatë gjithë ciklit të tyre të studimit në institucion. Gjithashtu, studentët dhe stafi akademik që mori pjesë në takimin më grupin e vlerësimit të jashtëm, ishin të njohur mirë me sistemin dhe mënyrën e veprimit të tij. Sistemi i operimit BIS shpjegohet në Udhëzuesin për përdorimin e këtij sistemi. <i>Evidenca nr. 25 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BTS)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sipas shpjegimeve të dhëna në RVB dhe evidencat e dorëzuara në dosjen e vlerësimit, sistemi i menaxhimit të brendshëm BIS, ka llogari të hapura për secilën nga grupet, në institucion: studentët, pedagogët, këshilltarët akademike, dhe departamentet e tjera mbështetëse në institucion si p.sh. burimet njerëzore, biblioteka, sekretaria, zyrat specifike, etj. Në sistemin e menaxhimit të brendshëm institucioni ruan të gjitha të dhënat që lidhen me progresin e studentëve në ciklin e programit. <i>Evidenca nr. 25 Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BTS)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Qasja në sistemin e menaxhimit të brendshëm BIS, është e hapur, me password individuale, për të gjithë stafin pedagogjik të programit, studentët dhe stafin mbështetës. Sipas informacioneve të dhëna në RVB dhe nga intervistat në institucion, grupit të vlerësimit të jashtëm iu shpjegua se ky sistem përfshinte të gjitha notat, lëndët, vlerësimet, dhe komunikimet e nevojshme të stafit

	pedagogjik me studentët si dhe komunikimet e këtyre të fundit me departamentet mbështetëse në institucion. <i>Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BTS)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Siç përshkruhet në shtojcën tabela nr. 17, institucioni ka të integruar në sistemin e brendshëm të menaxhimit edhe platformën beder.edu.al, e cila u ofron të gjithë përdoruesve llogari e-mail me përdorim gjatë kohës së studimit me adresë emermbieter@beder.edu.al. Ndërkohë nëpërmjet platformës BIS, menaxhohet gjithë sistemi i të dhënave të studentëve, që nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve të tyre. Për personelin gjithashtu bëhet e mundur menaxhimi i dokumentacionit që prej fillimit të marrëdhënies së punës e deri në përfundimin e kontratës, së tyre. Një platformë shumë e përdorshme në komunikimin interaktiv mes pedagogëve dhe studentëve është edhe Google Classroom tek e cila mund të hyhet nëpërmjet e-mail të hapur në KU Bedër.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit BIS mundëson marrjen e të dhënave në kohë reale për të gjithë studentët, progresin e tyre, si dhe procedurat e nevojshme financiare dhe administrative. <i>Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BTS)</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni ka informacion të nevojshëm dhe konkret në faqen elektronike https://www.beder.edu.al/ e cila është lehtësisht e aksesueshme. Informacioni në faqe ofrohet në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, dhe përmban gjithë informacionet për programet e studimit, aktivitetet e institucionit, stafit akademik, departamenteve të tjera mbështetëse etj. Nga një kontroll i thjeshtë i faqes (aksesuar më datë 20 mars 2025), vihet re informacioni mbi programet mësimore, orarin mësimor, kalendarin akademik, si edhe informacionet për kriteret e pranimit, si edhe informacione për klubet studentore, etj. <i>Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Bedër (BTS)</i>
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional BIS dhe e vë atë në dispozicion të

	<i>administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në institucion, GVJ vëren se KU Bedër bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare. Të dhënat e paraqitura në tabelën 18 në Shtojcë i përkasin institucionit dhe dokumenti tjetër jep planifikimin e Buxhetit specifikisht për Departamentin e Shkencave të Komunikimit. KU Bedër është institucion i arsimit të lartë, jofitimprurës dhe pjesën më të madhe të financimeve vjen nga donacionet, aktivitetet siguruese dhe fondacioni. Në tre vitet e fundit, kjo shifër luhet nga 43- 54% pjesë e buxhetit. Megjithëse ajo ka ardhur me zbritje të lehtë nga viti në vit, ende vazhdon të mbetet e konsiderueshme si në vlerë relative dhe absolute. KU Bedër duhet të konsiderojë një diversifikim më të madh të fondeve të financimit. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. Tabela 18</i>

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Në dokumentin e planifikimit të buxhetit për Departamentin e Shkencave të Komunikimit janë të përcaktuar zërat si tek të ardhurat, ashtu edhe të shpenzimet. Plani i financimit të Departamentit përmban financimin e shpenzimeve për kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen në evente/konferenca/seminare, materiale, marketing, shpenzime për aktivitete studentore, literaturë të re, etj. Planifikim përfshin të ardhurat si seminarët, konferencat, projektet, etj. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. Tabela 18</i> <i>Evidenca nr. 78 Projekt Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas Nenit 1 të Statutit Kolegji Universitar Bedër është një person juridik jofitimprurës me karakter ndërkombëtar. Sipas dokumentacionit, KU Bedër kryen auditim të rregullt. Dokumenti i përcjellë është auditimi i brendshëm i kryer në institucion për periudhën 1 nëntor 2021 deri në 3 maj 2024. Sipas RVB, një kontabilisti i miratuar harton një raport të situatës financiare në mënyrë periodike vjetore, i cili ruhet pranë Fondacionit “Hafiz Ali Korça”.
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sikurse përshkruhet në RVB, raportet dhe analizat financiare dhe monitorimi i treguesve financiarë realizohet nga fondacioni pjesë e të cilit është edhe KU Bedër. Në fund të çdo viti akademik KU Bedër i paraqet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Raportin Vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar si edhe parashikimi për buxhetin e vitit të ardhshëm.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet	Mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionin e përcjellë nga institucioni mbi të ardhurat e pasqyruara në Shtojcën e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm/Tabelave përmbledhëse rezulton shifra të ardhurash që sigurohen nga tre burime kryesore:

financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	1. Grantet për kërkimin shkencor dhe kontratat; 2. Konsulencat dhe shërbimet; 3. Tarifat e shkollimit; 4. Donacione, aktivitetet siguruese dhe fondacionet; Nga raporti i RVB në vitet 2021-2024 institucioni ka pasur rritje graduale të të ardhurave pothuajse në të gjitha zërat, ku rritja më e lehtë është në tarifat e shkollimit dhe rritja më e madhe është në konsulencat dhe shërbimet. Donacionet dhe Tarifat e shkollimit janë dy elementët që sjellin pjesën më të madhe të të ardhurave, me një vlerë pak më të madhe të donacioneve. Megjithatë, diversifikimi i burimeve të financimit, është një mundësi që duhet konsideruar në menaxhimin e institucionit. Shifrat e paraqitura në evidencat dhe RVB tregojnë për qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. <i>Evidenca Shtojca – Tabela – Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit. Tabela 18</i>
Konkluzione	<i>GVJ duke u mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacionin e përcjellë nga institucioni mbi të ardhurat e realizuara në një periudhë 2021-2024 vlerëson se institucioni ka pasur deri tani qëndrueshmëri financiare dhe të ardhura që kanë ardhur në rritje.</i> <i>Mbështetur në dokumentacionin e përcjellë nga institucioni dhe informacionin e siguruar gjatë vizitave në KU Bedër, GVJ vëren se KU Bedër ka burime njerëzore të kualifikuara me eksperiencë të cilësuar akademike, të përshtatshme për programin e studimit. Ai ka një godinë dhe infrastrukturë mjedisore të përshtatshme që e pajis mjaft mirë studentin me kushtet për të zhvilluar një proces mësimor cilësor dhe me standarde. ILA bën një planifikim buxhetor dhe përdorim të burimeve financiare duke ndjekur disa procedura. Institucioni në statusin e tij është një person juridik jofitimprurës me karakter ndërkombëtar dhe bazohet në katër grupe të mëdha të të ardhurave si (i) Tarifat e shkollimit; (ii) Donacione, aktivitetet siguruese dhe fondacionet; (iii) Grantet për kërkimin shkencor dhe kontratat; si edhe (iv) Konsulencat dhe shërbimet.</i> <i>Donacione, aktivitetet siguruese dhe fondacionet janë ato që zënë vendin kryesor në burimin e të ardhurave.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në evidencat e sjella nga KU Bedër, rregulloret e hartuara dhe RVB, vlerësohet se institucioni ka hartuar politika të qarta për mënyrën e pranimin të studentëve, vlerësimin, matjen e performancës dhe të tjera kriteret që mbulojnë ciklin e plotë të studimeve për programin, nga hyrja e studentëve në program deri në përfundim të ciklit. Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër, Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master i shkencave në Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike janë baza institucionale për procedurat e studentëve gjatë gjithë ciklit akademik. Institucioni zbaton politika për ciklin e plotë akademik për studentët, në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Të gjitha këto specifikuar në rregulloret përkatëse, por edhe në guidën e studentit për ti dhënë atyre mundësinë për ti njohur procedurat që në momentin e fillimit të studimit. <i>Evidenca nr. 2 Rregullorja Themelore e Kolegjit Universitar Bedër</i>

	Evidenca nr. 28 Guida e Studentit Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat e hartuara nga institucioni, për të gjithë ciklin e studimit, për të gjithë studentët, siç paraqiten në “Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë” dhe “Rregullorja e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Komunikimi” me profile: “Marrëdhënie me Publikun”; “Gazetari”” janë jo diskriminuese dhe gjithëpërfshirëse. Gjithashtu institucioni ka në politika të përcaktuar edhe dy kategori si kategori të veçanta: Neni 20 dhe Neni 21 “Personat me aftësi të kufizuar” dhe “Studentët me aftësi të kufizuar”, në rregulloren e studimeve të ciklit të dytë. Procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve të rinj institucioni i publikon në faqen e tij ëeb dhe janë gjithashtu edhe të aksesueshme përmes portalit U-Albania nëpërmjet një kodi personal nga të gjithë të interesuarit. Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret e pranimit të studentëve të aplikuar nga KU Bedër janë kriteret e përgjithshme që garantojnë barazinë për të gjithë studentët. Ato mbështetet në legjislacionin dhe bazën rregullative të hartuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të lidhura edhe me Maturën Shtetërore. KU Bedër harton dhe publikon kriteret për pranimin e studentëve të rinj, përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara dhe të përfshira edhe në Rregulloren e programit (Evidenca nr.7). Kriteret publikohen edhe në faqen online të Bedër. Sipas praktikave të njohura edhe nga Ministria e Arsimit, KU Bedër bashkëpunon edhe me drejtorisë arsimore rajonale dhe institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të promovuar programet e saj të studimit dhe nxitur pjesëmarrjen/regjistrimin në këto programe.

	Komisioni përzgjedhës i studentëve fitues në program ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit. Informacioni gjendet edhe në faqen zyrtare online të KU Bedër. <i>Evidenca nr. 9 Vendim Per Ngritjen e Komisionit per Perzgjedhjen e Studenteve Fitues per Programin Master</i> <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>Evidenca nr. 91 Vendim Senati mbi kriteret e pranimit te studenteve</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	KU Bedër ka të përcaktuara rregulloret dhe politikat në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së studentëve, përparimin e tyre vlerësimet dhe transferimet. Transferimi i studentëve është i përcaktuar Institucioni në rregulloren përkatëse dhe jep të përcaktuara kushtet që duhen plotësuar si edhe proceset administrative, organi vendimmarrës që merret me transferimet. Procedura fillon nga departamenti përkatës dhe vendimi përfundimtar është i një komisioni <i>ad-hoc</i> të ngritur për këtë qëllim. Të dhëna për këto kritere janë të pasqyruara edhe në Guidën e studentit si edhe në faqen online të institucionit, https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimit https://www.beder.edu.al/pranimet/transferimi-i-studimeve KU Bedër bazuar në procedurat e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, merr pjesë në panairët rajonale apo workshop-e specifike për të prezantuar ofertën akademike të studimeve. <i>Evidenca nr. 9 Vendim Per Ngritjen e Komisionit per Perzgjedhjen e Studenteve Fitues per Programin Master</i> <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>Evidenca nr. 91 Vendim Senati mbi kriteret e pranimit te studenteve</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i>

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Sipas informacionit të përcjellë nga RVB dhe dokumentacionit përkatës, KU Bedër e bën informimin e publikut për ofertën për këtë program studimi nëpërmjet disa mënyrave: - Publikimit të informacioneve në faqen online https://www.beder.edu.al/ - Pjesëmarrjes në panairët arsim dhe karrierë, rajonale/lokale që zhvillohen në fillim të çdo viti akademik, si edhe takimet/vizitat me shkollat e mesme. - Guidës së studentit dhe publikimeve të tjera promovuese. - Përdorimit të rrjeteve sociale për promovimin e studimeve sipas profileve të cilat menaxhohen nga njësitë bazë. https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimet https://www.beder.edu.al/pranimet/transferimi-i-studimeve
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Bazuar në rregulloret e programit të studimit, KU Bedër para fillimit të vitit bën publike Vendimin e Senatit mbi kriteret e pranimet të studentëve. Sipas “Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë”, ka politika të përcaktuar edhe kategori të veçanta. Sipas Neni 21 “Studentët me aftësi të kufizuara” “... KU Bedër ofron mundësi për arsimimin e studentëve me aftësi të kufizuara dhe garanton që arsimimi i personave me aftësi të kufizuara të jete pjesë integrale e sistemit arsimor të saj. Mosdiskriminimi i studentëve me aftësi të kufizuara dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë është një ndër parimet e rëndësishme të KU Bedër.” Nga pikëpamja infrastrukturore KU Bedër ka siguruar të gjitha lehtësitë dhe shërbimet mbështetëse, të projektuara në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, që mund të bëhen studentë në programet e këtij kolegji universitar. Gjithashtu institucioni ka të përcaktuar edhe mundësi për të dhënë bursa të veçanta për studentë nga grupe të marginalizuara. <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-per-burse
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	KU Bedër harton dhe publikon në faqen web edhe kriteret e përzgjedhjes së studentëve nga shtete të tjera. Neni 32 i rregullores së këtij programi studimi paraqet procedurat për studentët e dërguar në kuadër të bashkëpunimit me universitetet e huaja.

	Në rregulloren e programit të studimit saktësohet që për këtë program gjuha e studimit është gjuha shqipe dhe me njohuri të gjuhëve të huaj në nivelin B1 ose ekuivalent për një nga pesë gjuhët e huaja. Dëshmia e njohurive për këto gjuhë duhet të jetë e marrë jo më larg se përpara dy vjetësh. <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 91 Vendim Senati mbi kriteret e pranimit të studenteve</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit të Studimit Master i shkencave në Shkencë Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marrëdhënie Publike</i> https://www.beder.edu.al/pranimet/apliko-online			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Rregullorja për zbritjen e tarifave të studimit ka politika të përcaktuara në “Studentët që përfitojnë zbritje nga tarifat e studimit”, në ciklin e dytë. Procedura ka të përcaktuar detyrimet studentore për të përfituar nga këto zbritje tarife. Gjithashtu në faqen online të KU Bedër janë të përcaktuara edhe kriteret për të përfituar nga Bursat e Ekselencës, Bursat Sociale dhe Bursat e talentit. Këto përfitohen nga studentë me status jetimi, pa kujdestari prindërore, me pamundësi ekonomike, fëmijë të dëshmorëve/ të rënëve në detyrë, me status invalidi, para dhe tetraplegjik. <i>Evidenca nr. 47 Rregullorja për zbritjen e tarifave të studimit</i>			
Konkluzione	GVJ mbështetur në dokumentacionin e përcjellë vëren se KU Bedër ka krijuar një bazë të plotë dokumentare që ndjek studentët që nga procesi i regjistrimit deri në diplomimin e plotë nga programi mësimor duke krijuar barazi dhe mosdiskriminim të studentëve. Rregulloret përkatëse mbështetën edhe studentët me aftësi ndryshe për të lehtësuar studimin e tyre në KU Bedër. Gjithashtu për studentët nga grupet e marginalizuara institucioni ofron edhe bursa të plota ose të pjesshme studimi. I gjithë informacioni është publik dhe i hapur për studentët. GVJ vlerëson plotësisht të përmbushur këtë standard.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni ka disa mënyra nëpërmjet të cilave sigurohet që studentët të marrin informacion të bollshëm mbi ecurinë akademike dhe përparimin nga një vit në tjetrin. Informacioni fillon që me javën e orientimit, e cila zhvillohet përpara fillimit të çdo viti akademik. Informacioni vijon me publikimin e “Guidës së studentit” si në formatin e printuar edhe atë online. Pas regjistrimit studentët mund të komunikojnë me sekretarinë mësimore apo koordinatoren e departamentit për të parë ecurinë e tyre. Që në procesin e regjistrimit, studentët pajisen me një adresë e-mail dhe me mundësi aksesit në sistemin e informimit BIS ku kanë edhe mundësinë e shikimit të notave, mungesave, syllabuset e lëndëve dhe mjaft informacione të tjera. Një tjetër mbështetës është edhe këshilltari akademik i cili i orienton në çdo hap të ecurisë së tyre akademike. Studentët që morën pjesë në intervistat me GJVJ e konfirmuan pjesëmarrjen e tyre në këtë javë orientimi dhe asistencën që ata marrin në orientimin e tyre si nga Këshilltari akademik ashtu edhe informacionin e përcjellë nga sekretaria mësimore. <i>Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Beder (BTS)</i> <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit të Studimit Master i shkencave në Shkencë Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i> <i>Evidenca nr. 107 Udhezuesi i Këshilltarit Akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të	Guida e Studentit është një dokument i plotë dhe informues mbi informacionet praktike që i duhen studentit. Po ashtu rregullorja e programit të studimit ka të saktësuar edhe kriteret e nevojshme për transferimin e studimeve. Si dokument i veçantë rregullorja e transferimeve përmban gjithë informacionin e nevojshëm për

mëparshme ose studimeve të pjesshme.	studentët lidhur me njohjen e krediteve/kualifikimeve të mëparshme dhe studimeve të pjesshme. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i> <i>Evidenca nr. 99 Rregullorja e Transferimit te Studimeve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	KU Bedër nëpërmjet disa mënyrave të përmendura edhe më lart informon studentët për modulet, lëndët dhe veprimtaritë e ndryshme. Brenda secilit nga syllabuset e lëndëve janë të përshkruara edhe mënyrat e vlerësimit të dijeve të studentëve. Më herët që në procesin e regjistrimit, nëpërmjet “Guidës së studentit”, studentët kanë mundësinë të aksesojnë info. Sistemi BIS, nëpërmjet llogarisë personale të studentit, ata kanë akses në gjithë ecurinë e tyre akademike. Një mundësi tjetër është edhe kontakti i drejtpërdrejtë me sekretarinë. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i> <i>Evidenca nr. 112 Shembull Silabusi</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret e punimit të diplomës janë në dispozicion të studentëve si nëpërmjet rregulloreve të programit të studimit, ashtu edhe nga dokumentacioni specifik “Manuali për Përgatitjen e Tezës së Diplomës dhe Kriteret e Vlerësimit të Tezës për Studentet e Ciklit të Dytë”. Gjithashtu nëpërmjet “Guidës së studentit” jepet informacion më të përgjithshëm mbi kriteret e punimit dhe diplomimit. Më tej rregulloret e programit të studimit dhe sistemit BIS u japin studentëve informacionin lidhur me ecurinë e studimeve të tyre deri në diplomim. Informacion jep edhe kurikula e programit të studimit.

	Evidenca nr. 28 Guida e Studentit Evidenca nr. 34 Kurrikula e Programit te studimit Master i Shkencave ne Shkenca Komunikimi, me profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike Evidenca nr. 41 Manuali per Pergatitjen e Tezes se Diplomes dhe Kriteret e Vleresimit te Tezes per Studentet e Ciklit te Dyte.pdf Evidenca nr. 90 Rregullorja per programet e studimit te ciklit te dyte Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit te Studimit Master i shkencave ne Shkenca Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	KU Bedër mban kontakte me drejtoritë rajonale arsimore përmes panairove të edukimit dhe karrierës në nivel rajonal dhe qytetesh. Faqja online e KU Bedër përditësohet me informacionet në mënyrë që të promovohen programet e studimit dhe mundësitë e regjistrimit edhe në formë online. Institucioni gjithashtu publikon broshura dhe fletëpalosje për të promovuar programet e studimit. Evidenca nr. 28 Guida e Studentit. Evidenca nr. 112 Shembull Silabusi https://www.beder.edu.al/pranimet/kriteret-e-pranimet https://www.beder.edu.al/pranimet/transferimi-i-studimeve			
Konkluzione	GVJ vlerëson se ky standard përputhet plotësisht. KU Bedër ka disa mënyra nëpërmjet të cilave sigurohet që studentët të marrin informacion të bollshëm mbi ecurinë akademike, përparimin nga një vit në tjetrin, hartimin e diplomës. Informacioni fillon që me javën e orientimit, e cila zhvillohet përpara fillimit të çdo viti akademik. Informacioni vijon me publikimin e "Guidës së studentit" si në formatin e printuar edhe atë online, nëpërmjet sistemit të informimit BIS me llogari individuale si edhe nga komunikimet me sekretarinë mësimore apo koordinatoren e departamentit për të parë ecurinë e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Fillimi i procesit të informimit të studentëve nis që me ditët e orientimit. Dhe këshilltari akademik është i përcaktuar pranë çdo departamenti i cili prezanton grupin e studentëve me zyrat kryesore që ka KU Bedër. Këshilltari është një pikë shumë e rëndësishme ndërlidhëse për informacionin që marrin studentët, organizimin dhe orientimin e tyre përgjatë gjithë kohës së studimit. Institucioni nëpërmjet disa mënyrave vë në dispozicion të studentëve informacionin dhe dokumentacion të posaçëm për organizimin, kohëzgjatjen, modulet, lëndët të këtij programi studimi. Informacioni jepet në syllabuset e lëndëve, në broshurat dhe publikimet e tjera dhe në takimet e drejtpërdrejta me stafin dhe personelin akademik të programit të studimit. “Guida e studentit” është një mundësi fillestare informimi shumë e rëndësishme. Gjithashtu, studentët kanë mundësinë të aksesojnë info edhe nëpërmjet sistemit BIS, nëpërmjet adresës personale me password individual, si edhe në kontakt me sekretarinë. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 107 Udhezuesi i Keshilltarit Akademik</i> <i>Evidenca nr. 112 Shembull Silabusi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët që prej momentit të këshillimit akademik dhe regjistrimit në programin e studimit marrin informacion për programin e lëndëve. Më pas në javën e orientimit dhe me informacionin nga sekretaria mësimore dhe takimi me pedagogët ata marrin syllabuset e lëndëve, me informacion të plotë për mënyrën se si janë organizuar lëndët, modulet mësimore e veprimtaritë formuese. Ato përshkruajnë, temat, ngarkesën në orë mësimore, literaturë e detyrueshme dhe të rekomanduar, format e kontrollit të dijeve, etj. Departamenti i Shkencave të Komunikimit ku zhvillohet ky program studimi informon në mënyrë të vazhdueshme studentët për aktivitetin mësimor. Sekretaria mësimore mbështet gjithnjë studentët për orientim dhe dhënie informacioni. <i>Evidenca nr. 8 Rregullorja e Zyres se Sekretarise Mesimore</i> <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 112 Shembull Silabusi</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Informacioni për tregun e punës jepet në disa forma. Një ndër të është informacioni i përcjellë nga Zyra e Planifikimit të Karrierës, pranë Dekanit të Studentëve. Edhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit përcjell informacione mbi kërkesat nga tregu i punës. Departamenti dhe Zyra janë mjaft të përfshira në procesin e asistencës për punësimin e studentëve. Një përfaqësues i Departament zgjidhet si përfaqësues pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës. Roli i Këshilltarit lidhet edhe me organizimin e seminareve për shkrimin e cv, praktikimin e intervistave të punës, etj. Këshilltari Akademik dhe Zyrës së Planifikimit të Karrierës janë dy pika lidhëse shumë të rëndësishme midis studentëve dhe tregut të punës. Sikurse u mësua edhe gjatë vizitës në KU Bedër studentët u shprehën për mundësitë që u ofron institucioni nëpërmjet kontakteve me media të ndryshme dhe si kanë ndihmuar ato në vendosjen e lidhjeve dhe punësimet e pjesshme ose të plota gjatë dhe pas mbarimit të studimeve. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 79 Raport i Zyres se Planifikimit te Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 18 Vendim per caktimin e Keshilltareve Akademike per Programet Master, viti akademik 2024 2025</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Informacioni i studentëve lidhur me programin e studimit jepet në forma të ndryshme. (Me nënshkrimin e kontratës së studimit në program, nëpërmjet broshurës së programeve Master, nëpërmjet sistemit të komunikimit online, si edhe me sekretarinë mësimore). Në ditët e orientimit, secila nga Zyrat e KU Bedër organizon prezantimin e aktivitetit të saj në ndihmë të studentëve. Menjëherë pas regjistrimit në program studentet asistohen nga zyra e IT të krijojnë llogarinë e tyre të e-mail dhe mundësinë e aksesit në BIS për të marrë gjithë informacionin e nevojshme. Kjo platformë krijon mundësinë edhe të komunikimit me pedagogët në distancë. Sistemi është mjaft i përdorshëm për studentët për dhënie të informacionit lidhur me kalendarin akademik, procesin mësimor, aktivitetet extrakurrikulare, etj. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 79 Raport i Zyres se Planifikimit te Karrieres</i> <i>Evidenca nr. 18 Vendim per caktimin e Keshilltareve Akademike per Programet Master, viti akademik 2024 2025</i>

Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit mundëson lidhjen e studentëve me pedagogët, departamentin dhe njësitë e tjera administrative në KU Bedër. Të gjithë studentët dhe pedagogët kanë llogarinë e tyre për të komunikuar online. Sistemi ka të gjithë informacionin për programin e studimit specifik. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit.</i> <i>Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Beder (BTS)</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër informon studentët mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni ka ndërtuar një sistem informimi online, BIS me anë të të cilit përcillen informacionet lehtësisht ta aksesueshme dhe në kohe reale për ecurinë akademike, informacion mbi programin e studimit dhe aktivitetet ekstrakurrikulare dhe mundësitë për tu orientuar dhe përshtatur me tregun e punës. Vlerësohet se ky standard përputhet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria Mësimore e KU Bedër mban informacione të plota për statistikat e studentëve në hyrje dhe në dalje për secilin fakultet dhe program studimi. Gjatë vizitës së GVJ në Sekretarinë Mësimore u njohën me mënyrën e mbajtjes së informacionit dhe ruajtjen e tij sipas rregulloreve.			
	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studente të transferuar	Studentë gjithsej
	2022-2023	9	-	9
	2023-2024	11	-	11
	2024-2025	17	-	17
	Dokumenti “Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve” jep informacione për studentët gjatë tre viteve të fundit 2022-2025 si			

	për cilësinë e tyre në fillim të programit të studimit e cila ishte mbi 8.3 për të tre këto vite. Po kështu në informacionin e Zyrës së të Diplomuarve gjendet statistikat për diplomimin e studentëve të të gjitha programet e studimit. Sekretaria mësimore, me anë të regjistrave të saj, ka statistikat e studentëve të regjistruar në programin e studimit, rezultatet e provimeve, lëvizjet, largimet, cilësinë e studentëve në hyrje, si edhe diplomimet, etj. Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve Evidenca nr. 8 Rregullorja e Zyres se Sekretarise Mesimore Evidenca nr. 80 Raport i Zyres se te Diplomuarve								
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria Mësimore në KU Bedër disponon statistikat e programit të studimit <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th><th>Studentë të diplomuar</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td><td>17</td></tr> <tr> <td>2022-2023</td><td>14</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>11</td></tr> </tbody> </table> Tabela 21 Cilësia në hyrje dhe dalje e studentëve Tabela 23 dhe 24 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve	Viti akademik	Studentë të diplomuar	2021-2022	17	2022-2023	14	2023-2024	11
Viti akademik	Studentë të diplomuar								
2021-2022	17								
2022-2023	14								
2023-2024	11								
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Sekretarinë Mësimore, gjendet dosja e çdo studenti me informacionin e duhur, më të dhënat e rezultateve në provime dhe ecurinë vit pas viti. Ky informacion është i ruajtur edhe në sistemin elektronik, BIS, si edhe në regjistrat e depozituar në sekretarinë mësimore. GVJ u njoh me këto regjistra gjatë vizitës në institucion. Evidenca nr. 8 Rregullorja e Zyres se Sekretarise Mesimore Evidenca nr. 25 Udhezues i Sistemit Informativ Beder Evidenca nr. 107 Udhezuesi i Keshilltarit Akademik								
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit,	KU Bedër e mbështet veprimtarinë e tij në një bazë rregullative rregulloresh dhe aktesh administrative të miratuara nga Senati Akademik, Rektorati dhe Bordi i Administrimit. Institucioni kryen çdo vit auditim të brendshëm të zyrave dhe njësive të tij administrative duke vlerësuar procedurat e ndjekura në marrjen dhe përpunimin e informacionit. Raporti i auditimit me rezultatet dhe rekomandimet e lëna përcillet tek njësitë respektive.								

etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Evidenca nr. 71 Procedura per Auditim Periodik te Brendshem</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	KU Bedër dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit ndjekin në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e studentëve në hyrje të programit dhe në dalje të tij. Raportet e hartuara shërbejnë për zhvillimin e ecurinë e punës më tej. Me përfundimin e vitit akademik, Departamenti harton Raportin Vjetor që përfshin si të dhënat e departamentit ashtu edhe për studentët sipas programeve të studimit. Ky raport është pjesë e Raportit të gjerë institucional. Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh edhe me komunikimet e pedagogeve me studentët dhe orientimin që ata bëjnë për cilësinë dhe ecurinë e studimeve të tyre. <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit 2023 2024</i> <i>Evidenca nr. 86 Raporti Vjetor Institucional</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit, si nëpërmjet regjistrave ashtu edhe në formatin elektronik, nëpërmjet sistemit të ndërtuar BIS dhe që janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga linjat e hierarkisë së institucionit. Njësia bazë harton raportin vjetor në fund të çdo viti akademik dhe institucioni kryen procedure te rregullt të auditimit të brendshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre	Statuti i KU Bedër përcakton që në përbërjen e organeve drejtuese ku janë anëtarë edhe studentët. Në Nenin 10, përbërja e Senatit Akademik është e saktësuar se studentët janë pjesë e Senatit

në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Akademik. Studentët janë të përfaqësuar edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Rregullorja e organizimit administrativ përfshin edhe angazhimin dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve në organet këshilluese dhe vendimmarrëse. Mendimi i studentëve merret edhe në mbledhjet e Këshillit të Departamentit apo fakultetit ku ngrihen edhe çështje që përcillen nga vetë studentët. Gjithashtu, me një vendim të Senatit të marrë që në vitin 2015, studentët janë të përfshirë në Këshillat e Fakultetit. <i>Evidenca 1. Statuti i KU Bedër</i> <i>Evidenca nr. 43 Vendimi i senatit per perfshirjen e studenteve ne keshillin e departamentit.</i> <i>Evidenca nr. 89 Rezultatet e zgjedhjeve Studentore 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 108 Studentet perfaqesues ne mbledhjet e Keshillit te Departamentit</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përveç bazës rregullative që siguron përfshirjen e studentëve në disa organe të rëndësishme të drejtimit të KU Bedër, institucioni ka ngritur edhe pozicionin e Dekanit të Studentëve, i cili siguron mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Sikurse lexohet edhe në Raportet Vjetore të Departamentit ta Shkencave të Komunikimit në vite, përfshirja e studentëve /përfaqësuesve të tyre është konkrete në tematikë dhe në proceset e ndryshimeve dhe zgjidhjeve. Dekani i Studentëve është njësi e rëndësishme e cila së bashku me zyrat përbërëse ndihmojnë studentët gjatë gjithë ecurisë së tyre që nga regjistrimi dhe deri në diplomim. <i>Evidenca nr. 5 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 85 Raporti vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit, 2023-2024</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në	Sikurse përshkruhet në RVB dhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit studentët janë të përfshirë në disa forma në punën e departamentit. Kjo realizohet si me anën e pyetësorëve të ndryshëm për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimit të programit të studimit. Anketimet përfshijnë vlerësimin anonim të studenteve për programin, lëndën dhe pedagogun, institucionin. Vlerësimi edhe i metodave të mësimdhënies shihet në çdo anketim dhe i shërben përmirësimit të tyre dhe përshtatjes me të nxënit sa më të mirë të studentëve. Në pyetësor ruhet anonimati i studentëve.

departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën për mundësitë që u ofron universiteti në diskutime dhe kontakte të afërta me pedagogët dhe departamentin dhe u evidentuan si shembull lëndët e lidhura me krijim dhe zbatimin e fushatave publicitare të tilla si “Planeti nuk është tavllë” si edhe krijimi gjatë kohës së Pandemisë së Covid 19 të startup si “dritare e mundësive”. <i>Evidenca nr. 5 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 85 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 11 Ankete Vleresuese për Lenden dhe Pedagogun nga Studentet</i> <i>Evidenca nr. 12 Ankete Vleresimi e Mendimit të Studenteve ndaj Institucionit</i> <i>Evidenca nr. 13 Ankete Vleresimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e brendshme të universitetit si edhe rregullorja specifike e programit të studimit përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më konkretisht mënyra e vlerësimit është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. KU Bedër ka miratuar edhe procedurën e ankimimit të notës. Në rastet e paraqitura të ankimimit të notës, shihet formulari i cili përmban edhe arsyet se pse studentët e bëjnë këtë ankimim të notës. Më pas procedura përfshin edhe ngritjen e komisionit për rishikimin/rivlerësimin e notës dhe deri edhe në relacionin përfundimtar të komisionit për ndryshimin ose jo të notës. Në shembuj e paraqitur, ankesat e studenteve lidhen më shumë me “gabime matematikore ose teknike” në vlerësim dhe më pas komisioni i ka ndryshuar këto vlerësime. <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 64 Praktika e një rasti ankimimi note</i> <i>Evidenca nr. 90 Rregullorja për programet e studimit të ciklit të dytë</i> <i>Evidenca nr. 98 Rregullorja e Programit të Studimit Master i shkencave në Shkencë Komunikimi me Profilet Gazetari dhe Marredhenie Publike</i>



Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Mënyrat e marrjes së informacionit nga studentët janë të ndryshme, si nëpërmjet përfaqësimit të tyre në mbledhje të departamentit, këshilla studentore, NJSBC, apo edhe nëpërmjet anketimeve për programin, institucionin, pedagogun. Gjithashtu studentët kanë të drejtë të ankimojnë notat dhe të kërkojnë rishikimin e tyre. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Mbështetur në informacionin e përcjellë nga institucioni, GVJ gjykon se KU Bedër ka procedura dhe zyra specifike për t'i shërbyer sa më mirë studentëve, bazuar edhe në aktet ligjore dhe rregullatore. Disa nga zyrat e posaçme të KU Bedër janë Zyra e Këshilltarit Akademik, Dekani i studentëve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Planifikimit të karrierë së Studentëve janë në shërbim të studentëve jo thjesht për informacion, por edhe për ti mbështetur në përzgjedhjet e tyre akademike. Institucioni ka në shërbim të informimit në distancë edhe sistemin BIS të përshkruar më lart. <i>Evidenca nr. 5 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 28 Guida e Studentit</i> <i>Evidenca nr. 112 Shembull Silabusi</i> <i>Evidenca nr. 77 Programi i Orientimit 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 82 Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	Sistemi i informimit të studentëve në KU Bedër ka në disa elementë të tij si Këshilltarin Akademik, Zyrën e Planifikimit të Karrierës, si pjesë e Zyrës së Dekanatit të Studentëve.

ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Informimi nis që me ditët e orientimit për të vijuar më pas gjatë të gjithë vitit akademik me këshillimet dhe plotësimet me informacione të ndryshme, edhe nga koordinatori i departamentit i cili ndjek të gjithë procesin mësimor. Gjithashtu përmes Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare studentët marrin informacione për projekte të ndryshme dhe mundësinë e mobilitetit në kuadër të shkëmbimit me universitetet të huaja. <i>Evidenca nr. 16 Vendim per caktimin e asistentit prane Zyres se Marredhenieve Nderkombetare</i> <i>Evidenca nr. 77 Programi i Orientimit 2023-2024</i> <i>Evidenca nr. 82 Vendimi i Keshillit te Departamentit per caktimin e Koordinatorëve te Programeve te Studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Planifikimit të Karrierës është në funksion pranë Dekanatit të Studentëve, pranë së cilës emërohet një Këshilltar nga çdo departament. Kjo zyrë i ndihmon studentët edhe në drejtim të aplikimeve për kurse trajnimi dhe përfshirjes në projekte të ndryshme, për trajnime online si edhe për praktikat. Funksioni i saj parësor është këshillimi gjatë kohëzgjatjes së procesit akademik të studentëve në të gjitha etapat deri në diplomim. Zyra e Planifikimit të Karrierës mban lidhje të ngushta me aktorët në tregun e punës, si në institucione ashtu edhe në biznese të ndryshme duke i informuar më tej studentët për aktivitete, trajnime, panairë të punës, etj. Kjo zyrë asiston studentët lidhur me praktikat profesionale të tyre, duke i mbështetur në plotësimin e gjithë dokumentacionit për aplikim pranë institucioneve publike apo private. <i>Evidenca nr. 5 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 16 Vendim per caktimin e asistentit prane Zyres se Marredhenieve Nderkombetare</i> <i>Evidenca nr. 69 Procedura e praktikës profesionale</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion	Zyra e Planifikimit të Karrierës bashkëpunon me njësitë e tjera administrative dhe sidomos me Dekanatin e studentëve dhe Zyrën e të Diplomuarve si edhe mbledh dhe përpunon edhe të dhënat e studentëve pas diplomimit. Departamenti i Shkencave të Komunikimit është mjaft aktiv në organizimin e aktiviteteve dhe ftesat për studentët e diplomuar për të dhënë eksperiencat e tyre.

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	KU Bedër që prej fillimit të tij në vitin 2011 ka diplomuar 2069 studentë, pjesa më e madhe e tyre në programin Bachelor dhe 799 në programin Master. Zyra ka statistika për diplomimin sipas programeve të studimit dhe kontaktet për pjesën më të madhe të tyre. Gjithashtu në raportin e kësaj zyre jepen edhe institucionet publike ku janë të punësuar një pjesë e të diplomuarve. Evidenca nr. 5 Rregullorja mbi Organizimin Administrativ Evidenca nr. 80 Raport i Zyres se te Diplomuarve			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve, për këshillimin, ndjekjen e përparimit tyre dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor si edhe orientimin në tregun e punës. Zyra e Planifikimit të Karrierës bashkëpunon me njësitë e tjera administrative në KU Bedër dhe sidomos me Dekanatin e studentëve dhe Zyrën e të Diplomuarve duke mbajtur të gjithë informacionin dhe mbështetur studentët në plotësimin e dokumentacionit për praktikat profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave	Mbështetur në informacionin dokumentar të përcjellë dhe atë të marrë gjatë vizitës nga institucioni, GVJ gjykon se KU Bedër ka rregullore të brendshme dhe udhëzim për t'i shërbyer metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënit të studentëve.

të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Eksperiencia e viteve 2020, me përshtatjen e mësimdhënies gjatë pandemisë Covid 19, solli reflektim, kërkim dhe përdorim të formave të reja të mësimdhënies, nëpërmjet <i>Google classroom</i>. Përdorimi i këtyre formave vijon edhe sot. Pedagogët në këtë program studimi, gjatë vizitës u shprehën se atyre u janë bërë trajnime dhe i përdorin këto forma edhe në module të ndryshme mësimore nëpërmjet komunikimit online. Udhëzimi mbi mësimdhënie në distancë i datës 24/03/2020 shpjegon të gjithë procesin, metodat e mësimdhënies në distancë, procedurat e vlerësimit, format e provimit të njohurive, mënyrat e arkivimit të detyrave dhe provimeve ankimimin ndaj rezultateve të provimeve etj. Evidenca nr. 114 Udhëzim mbi mesimdhënie në distancë
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	“Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve” është ndërtuar në vitin 2012 dhe e përditësuar në vijimësi. https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf KU Bedër ka ndërtuar Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit. Ky është një organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimit. Rregullorja për funksionimin e tij është e përditësuar në vitin 2019. Ky komision “... nxjerr urdhër dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, NJSBC, në KU Bedër është krijuar bazuar në Statutin dhe Rregullores së Organizimit të Brendshëm të institucionit. NJSBC është organizmi kryesor përgjegjës “... për vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore, për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të vlerësimit akademik dhe administrativ për përmirësimin e cilësisë nëpërmjet raporteve të vlerësimit, kontrollin periodik dhe ndjekjen e tyre në institucion.” Kjo njësi bashkëpunon me të gjitha fakultetet dhe njësitë bazë dhe harton çdo vit një plan/kalendar të vlerësimit semestral ku janë të përcaktuar monitorimet. Sipas rregullore përkatëse të hartuar që prej viti 2014 dhe përditësuar në vijim, institucioni përdor disa formate vlerësues për pedagogun dhe lëndën. Ky vlerësim bëhet çdo semestër dhe plotësohet nga autoriteti drejtues si edhe një anëtar i NJSBC.

	Rregullorja ka të përcaktuar edhe detyrat dhe kompetencat e NJSBC. Pranë kësaj njësie, në varësi të nevojave mund të krijohen edhe komisione <i>ad-hoc</i> <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i> <i>Evidenca nr. 10 Anketa e Stafit Akademik dhe Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 24 Procedura e vleresimit te performances se stafit akademik</i> <i>Evidenca nr. 97 Rregullorja e Funksionimit te Komisionit te Perhershëm per Garantimin e Standarteve Cilesise Programeve te Studimit</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Në KU Bedër zhvillohen disa formate të anketimeve me studentët. Rezultatet e anketimeve përdoren në përmirësimin të metodave të mësimdhënies, pedagogut dhe syllabuset e lëndëve. Gjithashtu, në përbërje të NJSBC dhe grupet e vlerësimit të cilësisë dhe monitorimit të brendshëm përfshihen anëtarë të njësive bazë, një përfaqësues i Këshillit Studentor si edhe një ekspert i jashtëm. Studentët janë të përfshirë në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijes edhe nëpërmjet pyetësorëve semestralë për pedagogun dhe lëndën. Studentët e kanë të garantuar edhe mundësinë e ankimit të notës dhe KU Bedër ka nxjerrë një procedurë si vepohet për ankimin e notës. (Me hollësisht në pikën V.5.4) . <i>Evidenca nr. 7 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit si edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bazuar në rregulloret përkatëse bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. Raportet periodike mbi vërtetimet, monitorimet u dërgohen strukturave drejtuese të KU Bedër, por gjithashtu edhe pedagogëve sipas lëndëve përkatëse, si edhe drejtuesve të njësive bazë. Raportet janë edhe pjesë e diskutimeve në nivel dekanati për përmirësimin e cilësisë të mësimdhënies në institucion. Vlerësimet janë pjesë edhe e dosjes personale të pedagogut. Në faqen online të institucionit jepet baza rregullative për kontrollin e brendshëm të cilësisë. https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf

	Gjithashtu janë të publikuara edhe raportet dhe vendimet lidhur me këto kontrolle. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni ka të hartuar procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve që ofron. Diskutimet për përmirësimin e mësimdhënies, si edhe evidentimin e praktikave më të mira zhvillohen në nivel departamenti. Kjo i ndihmon pedagogët të shkëmbejnë praktikën e tyre bazuar edhe në përvoja të ngjashme brenda departamenteve. <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2023 2024</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se ka udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies si Google classroom. KU Bedër ka ndërtuar struktura si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë për të monitoruar dhe vlerësuar aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmësakademik. Në përbërje të këtyre njësive janë edhe përfaqësues të studentëve. Studentët përfshihen në anketimeve vjetore të gjithë procesit mësimdhënës në institucion. Rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve janë të publikuara në faqen zyrtare online të institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me	Mbështetur në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë” KU Bedër ka ndërtuar një bazë rregullatore dhe një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë të përbërë nga: 1. Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë Programeve të Studimit 2. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë

aktet rregullatore institucionale.	Komisioni i Përhershëm është një organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimit. Rregullorja për funksionimin e tij thekson se ky komision “... nxjerr urdhra dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, NJSBC ka rregulloren e saj të veçantë të funksionimit. Krahas detyrave të saj të përcaktuara qartësisht në këtë rregullore, pranë kësaj njësie mund të ngihen edhe grupe “grupet <i>ad-hoc</i>”, për vlerësimin e stafit akademik, etj. Gjithashtu institucioni ka ndërtuar edhe udhëzimin për procesin e zhvillimit të kurrikulave, që janë të gjitha në funksion të përsosjes së procesit të mësimdhënies. https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf Evidenca nr. 1 Statuti Evidenca nr. 7 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC Evidenca nr. 26 Udhëzimi mbi Procesin e Zhvillimit të Kurrikulave Evidenca nr. 56 Plani Strategjik Institucional 2018-2023 Evidenca nr. 57 Plani Strategjik Institucional 2024-2028 Evidenca nr. 59 Politika e cilësisë së KU Beder Evidenca nr. 60 Politika për Përmirësimin e programeve të studimit Evidenca nr. 97 Rregullorja e funksionimit të Komisionit të përhershëm SCIP
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në zbatim të legjislationit dhe bazës rregullatore të ndërtuar (siç u listua më sipër), KU Beder ka ngritur NJSBC me objektiv themelor monitorimin dhe ruajtjen e brendshme të cilësisë. Në “Rregullore për funksionimin dhe organizimin e NJSBC” është mirëpërcaktuar se cilët janë anëtarë të kësaj njësie. Janë pesë anëtarë dhe një përfaqësues nga këshilli Studentor dhe një Ekspert i jashtëm. Institucioni ka hartuar një Plan strategjik 2024-2028 ku cilësia është një ndër kapitujt e veçantë të tij. Ndër objektivat specifike të lidhur me cilësinë veçojmë: Objektivat e veçanta 1. <i>Rritje e cilësisë së programeve të studimit, përmirësim i infrastrukturës akademike dhe zbatim i standardeve të larta të vlerësimit institucional, me qëllim nxitjen e një kulture të vazhdueshme vlerësimi të qëndrueshëm, mendimi kritik dhe aftësi praktike në mësimdhënie, duke u vatëruar te studenti.</i>”

	Objektivat e veçanta 6. <i>Kualifikim, trajnim dhe mbështetje e vazhdueshme e stafit me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, avancimin institucional dhe promovimin në karrierë të stafit.</i> <i>Evidenca nr. 56 Plani Strategjik Institucional 2018-2023</i> <i>Evidenca nr. 57 Plani Strategjik Institucional 2024-2028</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi i cilësisë realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, siç janë mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm. Ndër instrumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë përmendim monitorimet, anketimet, dhe bashkëpunimet me ekspertë të jashtëm. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL. Raportet e Vlerësimit institucional nga agjencitë e ndryshme të akreditimit janë të publikuara në faqen online të KU Bedër. Akreditimi i parë institucional ka qenë nga APAAL. Në vitin 2017 është bërë akreditimi institucional nga Agjencia Britanike e Akreditimit “Quality Assurance Agency”. Akreditimi me i fundit institucional është nga ASCAL në 2021. KU Bedër ka bërë në mënyrë periodike akreditime të jashtme të programeve të studimit. Raportet e vlerësimit të brendshme dhe të jashtme bëhen publike në faqen online e institucionit. https://qac.beder.edu.al/files/Raporti-i-vleresimit-te-jashtem-institucional-2021.pdf
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni ka të zhvilluara një sërë formash anketimi të cilat e matin cilësinë e programeve nëpërmjet disa pikëpamjeve: atë të studentëve, stafit pedagogjik dhe stafit administrative. Këto instrumente janë të hartuara dhe miratuara, ndërkohe që përmbajtja e tyre rishikohet, herë pas here. Treguesit e përdorur për matjen e mësimdhënies dhe aktiviteteve kërkimore janë të përcaktuar në një dokumentesh dhe rregulloresh të hartuara nga KU Bedër. Gjithashtu edhe Plani Strategjik Institucional 2024-2028 ka të përcaktuar një seksion specifik për cilësinë. Universiteti ka ndërtuar procedura pune me lidhur me anketimet dhe monitorimet. https://dev.admin.beder.edu.al/documents/1666353606_rregullore-e-anketave-dhe-vleresimeve.pdf

	https://ëëë.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/cilesia Evidenca nr. 6 Rregullore e anketave dhe vleresimeve Evidenca nr. 85 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023-2024 Evidenca nr. 11 Ankete Vleresuese për Lenden dhe Pedagogun nga Studentet Evidenca nr. 12 Ankete Vleresimi e Mendimit të Studenteve ndaj Institucionit Evidenca nr. 13 Ankete Vleresimi i të Diplomuarve për Programin e Studimit Evidenca nr. 56 Plani Strategjik Institucional 2018-2023 Evidenca nr. 57 Plani Strategjik Institucional 2024-2028 Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër ka ngritur strukturën për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore. Kjo njësi zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë	Institucioni ka Njësine për Sigurimin e Cilësisë e cila është e angazhuar për vlerësimin e dy komponentëve të programit në mënyrë periodike: cilësinë e stafit akademik dhe të lëndëve sipas programeve të studimit. Këto dy vlerësime bëhen në fund të semestrit, pasi lënda është ofruar për studentët. Gjetjet që dalin nga këto procese anketimi, raportohen tek Zyra e Zhvillimit të Kurrikulës, për përshtatje të elementeve që kanë të bëjnë me kurrikulën. Ndërkohë çështjet që lidhen me stafin akademik, adresohen në departament.

proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Metodologjia e vlerësimit për programet e studimit është në rang institucioni, pra e njëtrajtësuar. (Ndryshimet qëndrojnë në objektivat e programeve të studimit apo shkallët krahasuese, por metodologjia dhe instrumentet e përdorura janë të njëjta.) <i>Evidenca nr. 6 Rregullore e anketave dhe vlerësimeve</i> <i>Evidenca nr. 85 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023-2024</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Metodat e vlerësimit të përdorura për matjen e cilësisë në këtë program janë disa pyetësor/anketime të cilat e matin performancën e programit nga disa këndvështrime: e studentëve, e stafit pedagogjik, si edhe e stafit administrativ. Përveç këtyre teknikave formale të matjes, studentët mund edhe të komunikojnë dhe shprehin shqetësimet e tyre pranë zyrave që janë në shërbim të tyre si p.sh. ajo e sekretarisë mësimore, këshillimit të karrierës, dekani i studentëve etj. Raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për të gjitha programet e studimit, diskutohen dhe bëhen publike te stafi dhe më pas shoqërohen edhe me masa për adresimin e problematikave, ashtu si edhe rastet pozitive. Këto dokumentohen si praktikatat e mira edhe në raportet e vlerësimit. Në diskutimet përcaktohen edhe njësitë bazë përgjegjëse për marrjen e masave dhe zgjidhjen e çështjeve. KU Bedër ka ndërtuar edhe Strategjinë e tij 2024-2028 duke e vënë në themel të tij edhe rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të saj në të gjitha programet e studimit. <i>Evidenca nr. 57 Plani Strategjik Institucional</i> <i>Evidenca nr. 85 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, 2023-2024</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës,	Institucioni përdor metoda të ndryshme vlerësimi për realizimin e mbarëvajtjes së procesit mësimdhënës të tilla si vlerësimi dhe diskutimi i kurrikulës, i literaturës vëzhgimi i provimeve dhe korrigjimi i tyre në rastet kur ka ankimim të notës etj. Gatë kryerjes së detyrave praktike të studentëve, ato prezantohen nga studentët edhe në formate me të gjera se sa auditori i grupit të tre mësimor. Gjithashtu gjatë takimit/vizitës në institucion drejtuesi

kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	i departamentit u shpreh për bashkëpunimin e ngushtë me stafin dhe diskutimet e programit mësimor që ata zhvillojnë përpara fillimit të vitit mësim. Këto forma vlerësimi janë të ndërthurura me vlerësimet përmes anketimeve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Institucioni përdor anketa vlerësimi, nga të gjitha grupet e përfshira në procesin mësimdhënës të tilla si studentët me fokus cilësinë e mësimdhënies, si dhe anketë vetëvlerësimi të pedagogut. Këto janë: 1. Anketa e vlerësimit të pedagogut dhe lëndës; 2. Anketa vjetore e kënaqësisë së studentit ndaj institucionit; 3. Anketa vjetore e kënaqësisë së stafit akademik ndaj institucionit; 4. Anketa e vlerësimit të studentëve për programin e studimit; 5. Anketa e vlerësimit të të diplomuarëve për programin e studimit. KU Bedër në dokumentin “Politika e Kolegji Universitar Bedër për Cilësinë” ka të përcaktuar edhe treguesit e rezultateve dhe cilësia e të cilëve përcaktohen nga organet drejtuese të institucionit, që janë: ▪ Cilësia e pranimit të studentëve, ▪ Përparimi dhe suksesi i studentëve, ▪ Cilësia dhe punësimi i të diplomuarëve, ▪ Vlerësimi i kurrikulës, ▪ Cilësia e kërkimit shkencor, ▪ Cilësia e publikimeve shkencore, ▪ Cilësia e shërbimeve të ofruara, ▪ Menaxhimi i financave, ▪ Përdorimi efektiv i burimeve dhe kapaciteteve, ▪ Kënaqësia (gëzimi a lumturia) e studentëve, ▪ Kënaqësia (gëzimi a lumturia) e personelit. Treguesit e rezultateve analizohen dhe vlerësohen nga njësitë përkatëse. Në bazë të rezultateve të arritura planifikohen masat dhe aktivitetet e duhura.

	Vihet re një fokus i madh tek studentë si target grup për pyetësorët në lidhje me performancën e programit si edhe të pedagogëve. Për stafin pedagogjik instrumentet të tjerë të matjes së cilësisë janë edhe vlerësimi nga vlerësim nga shefi i departamentit që asiston një orë leksioni, dhe komunikimet e problematikave me stafin mes kolegësh, etj. <i>Evidenca nr. 10 Anketa e Stafit Akademik dhe Administrativ</i> <i>Evidenca nr. 11 Anketa e studentit për pedagogun dhe lenden</i> <i>Evidenca nr. 12 Ankete vlerësimi i studenteve për institucionin</i> <i>Evidenca nr. 13 Ankete vlerësimi i studenteve për programin e studimit</i> <i>Evidenca nr. 14 Ankete vlerësimi i të diplomuarve për programin e studimit</i> <i>Evidenca nr. 59 Politika e Cilësisë në KU Bedër</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se KU Bedër përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë organizon anketime specifike me studentët si për vlerësimin e lëndëve, pedagogëve, të studimit ashtu edhe të institucionit. Drejtuesi i departamentit përdor edhe metodat të tjera të vlerësimi të drejtpërdrejt të mësimdhënies.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e	KU Bedër ka të përfshirë si anëtarë në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, një përfaqësues të studentëve, i zgjedhur nga Këshilli Studentor dhe një ekspert të jashtëm. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është operacionale dhe zhvillon rregullisht procese të matjes së cilësisë në institucion duke përfshirë të gjitha grupet e interesit, si: studentë, stafin pedagogjik, stafin administrative. Një rol të rëndësishëm në institucion lidhur me sigurimin e cilësisë luan edhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të

vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Cilësisë i cili harton politikat dhe monitoron zbatimin e tyre. Këto struktura kanë përfaqësues nga të dy fakultetet si edhe ekspertë të jashtëm. <i>Evidenca nr. 1 Statuti</i> <i>Evidenca nr. 59 Politika e Cilësisë në KU Bedër</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësisë dhe detyrat konkrete të Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë janë të parashikuara në rregulloret përkatëse. NJSBC ka akses në të gjithë informacionin e institucionit Baza rregullative e institucionit i ka të mirëhartuara përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë instancat e përfshira në sigurinë e cilësisë. Baza e vlerësimit për stafin akademik është edhe vetëvlerësimi individual. Këtij vlerësimi, duke i shtuar edhe ato periudha të bëra nga NJSBC përdoret në procesin e vlerësimit të performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik dhe përpara firmosjes së kontratës vjetore. <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në proceset e vlerësimit të cilësisë në institucion janë të përfshirë të gjithë aktorët e rëndësishëm të institucionit të tillë si: studentët, stafi akademik dhe stafi administrative. NJSBC bën një koordinim të mirë të punës për mbledhjen dhe shpërndarjen e gjetjeve të proceseve të vlerësimit me njësinë bazë dhe atë kryesore për këtë program studimi. Në fillim të çdo viti akademik bëhen analizat me stafin akademik, shkëmbehen eksperiencat dhe shikohen mundësitë për të zgjidhur problematikat në programet e ndryshme të studimit. <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2023 2024</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	Senati Akademik është njësi më e lartë e cila garanton respektimin e integritetit të të gjithë aktorëve të përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm. NJSBC, në procesin e plotësimit të pyetësorëve siguron anonimitetin dhe respekton integritetin akademik, shmang procese diskriminuese apo pabarazie mes stafit apo studentëve.

pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Pyetësorët, janë të hartuar në atë mënyrë që masin jo vetëm cilësinë e stafit pedagogjik, por edhe performancën e lëndës. Gjithashtu, pyetësorët përmbajnë edhe indikatorë sasior dhe cilësor, për ta bërë më të plotë matjen. Një nga rrugët e vlerësimit dhe shpërndarjes së eksperiencave pozitive, sikurse përshkruhet edhe në RVB janë analizat vjetore ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe administrativ të cilët shkëmbejnë përvoja dhe japin sugjerime për tematikat e shtruuara në këto analiza vjetore. KU Bedër ka të miratuar edhe dokumentin “Politikat për barazinë gjinore, mundësi të barabarta dhe diversitet” i cili i shërben më së miri shmangies së çdo lloj diskriminimi. <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit 2023 2024</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Siç u përmend më sipër, në Rregulloren Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në institucion, është përcaktuar që një prej anëtarëve të kësaj njësie, të jetë një ekspert i jashtëm dhe anëtari tjetër të jetë një student. Krahas pjesëmarrjes së një eksperti të jashtëm si pjesë e NJSBC, në KU Bedër departamentet përkatëse organizojnë takime të shpeshta me përfaqësues të industrisë dhe të të diplomuarve të cilët japin këndvështrime të ndryshme dhe ballafaqojnë tregun me programet mësimore. <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit te Shkencave te Komunikimit 2023 2024</i> <i>Evidenca nr. 72 Rregullorja per funksionimin dhe organizimin e NJSBC</i>
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se KU Bedër garanton procedura të brendshme të ruajtjes dhe rritjes së cilësisë duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë janë dy organizmat që garantojnë cilësinë. Ato së bashku me Senatin Akademik përpiqen që të shmangin proceset diskriminuese apo pabarazinë. Në përbërje të NJSBC merr pjesë edhe një përfaqësues i studnetëve.</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe baza rregullatore ku mbështetet aktiviteti i NJSBC në shërbim të rritjes së cilësisë për programet e studimit në të gjithë universitetin janë të miratuara dhe janë publike në faqen online të universitetit. Faqja online e NJSBC NJSBC harton kalendarin e aktivitetit të saj dhe e përcjell këtë tek rektori për diskutim pas komunikimit edhe me njësitë e tjera në KU Bedër. Raportet e vlerësimit u njoftohen edhe drejtuesve të departamenteve përkatëse, dhe publikohen në nënfaqen online të dedikuar sigurimit të cilësisë. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në faqen online të KU Bedër janë të publikuara rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për programet e studimit. Institucioni i konsideron mjaft të rëndësishme për mbarëvajtjen e mësimdhënies në universitet çështjet e etikës dhe lirinë akademike. Disa të dhëna që konsiderohen sensitive lidhur me monitorimin, përcillen tek individët dhe drejtuesi i drejtpërdrejtë, duke ruajtur hierarkinë e vendimmarrjes, por pa cenuar etikën dhe bazën rregullatore në fuqi. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/raportet https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/anketat https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise/vendime-te-bordit-te-akreditimit
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	GVJ u njoh me formatet e ndryshme të informacioneve të mbledhura në shërbim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie. Informacioni i mbledhur me të gjitha formatet (anketime, vëzhgime nga kolegët/drejtuesit e departamenteve, në orët e mësimi, etj.) përdoret si për të ndjekur ecurinë e progresit dhe për të zgjidhur

mangësive e dobësive të evidentuara.	problematika që mund të dalin nga sfidat në mësimdhënie dhe nxënie. Rezultatet nga vlerësimet diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi në rastet kur është e nevojshme. <i>Evidenca nr. 57 Plani Strategjik Institucional</i> <i>Evidenca nr. 85 Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit 2023 2024</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	KU Bedër i përdor informacionet e marra nga format e ndryshme të vrojtimit për t'i diskutuar me stafin akademik dhe linjat e hierarkisë në përmirësimin e mëtejshëm të programeve të studimit dhe mësimdhënies. Planet e punës dhe kalendari i aktiviteteve të NJSBC sigurojnë monitorimin dhe vlerësimin shumëplanësh të cilësisë në institucion.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NJSBC organizon seanca informuese me studentët dhe personelin e programeve të studimit, me synim përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në përmirësimin e cilësisë së programeve akademike. Kjo i shërben edhe ndërgjegjësimin të tyre për përfshirjen aktive në procesin e vlerësimit të brendshëm. Studentët janë pjesëmarrës në GVB dhe në organizmat që monitorojnë sigurimin e cilësisë. Gjithashtu, informacion të rëndësishëm studentët marrin edhe në javën e parë të orientimit lidhur me ecurinë dhe mënyrat për të kontribuar në cilësinë e programeve të studimit. https://www.beder.edu.al/rreth-nesh/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se KU Bedër bën publike organizimin dhe rezultatet e monitorimeve dhe raporteve të vlerësimit në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Gjithashtu publike janë edhe raportet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimeve. Personeli akademik dhe përfaqësues të studentëve janë pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Shkenca Komunikimi" me profile: "Marrëdhënie me Publikun"; "Gazetari" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Kolegji Universitar "Bedër".

Pikat e forta dhe afirmime

1. Korniza institucionale dhe infrastruktura - Programi zhvillohet brenda një institucioni të konsoliduar në arsimin e lartë privat në Shqipëri, me kapacitete infrastrukturore të përshtatshme për realizimin e programit.
2. Staf akademik i kualifikuar - Programi mbulohet nga staf akademik me grada shkencore përkatëse dhe me përvojë në fushën e komunikimit. Angazhimi i lektorëve me eksperiencë praktike në media dhe PR rrit vlerën e mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës.
3. Struktura dhe përmbajtja e kurrikulës - Kurrikula është e mirëstrukturuar, me një balancë ndërmjet komponentit teorik dhe praktik, që i përshtatet nivelit të ciklit të dytë. Përfshirja e praktikave profesionale dhe e moduleve të përqendruara në zhvillimin e aftësive të aplikueshme është një element pozitiv.
4. Mbështetja për studentët dhe veprimtaria kërkimore - Studentët përfitojnë nga mentorimi dhe orientimi akademik gjatë gjithë ciklit të studimeve. Programi inkurajon përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore dhe pjesëmarrjen në konferenca apo botime shkencore.
5. Përshtatshmëria me nevojat e tregut të punës - Programi adreson kërkesat aktuale të tregut të punës në fushën e komunikimit, medias dhe marrëdhënieve publike në sektorin publik dhe privat.

Pika të dobëta

1. Rritja e përfshirjes në projekte/network me universitete të tjera ndërkombëtare, duke i shërbyer edhe përfshirjes së teknologjive të reja të komunikimit në kurrikulë. - KU Beder ka arritur të jetë pjesë e disa projekteve ndërkombëtare, por përsëri nevojitet rritja e pjesëmarrjes në këto rrjetëzime të universiteteve ndërkombëtare duke u fokusuar edhe në përdorimin e teknologjive të reja digjitale dhe IA. Këto mund të jenë në formën edhe të seminareve speciale për studentët e këtij programi.
2. Nevoja për diversifikim të mëtejshëm të burimeve financiare për mbështetjen e programeve të studimit. – Ndër vite kolegji universitar ka treguar qëndrueshmëri financiare, por vazhdon të jetë e lartë, rreth 49%, pjesa e buxhetit që vjen nga "donacionet, aktivitetet sigurorese dhe fondacionet, etj". KU Beder duhet të shikojnë mundësitë për të rritur dhe përfshirë të ardhura të tjera në mundësitë financiare.
3. Promovimi i ulët ndërkombëtar i programit dhe sidomos në trevat shqipfolëse - KU Beder duhet të forcojë komponentin e marketimit më të fortë të programit duke thithur

më tepër studentë nga trevat shqipfolëse. Ky do të jetë një hap i rëndësishëm drejt njohjes me të gjerë ndërkombëtarisht, si edhe pjesëmarrjes së studentëve apo pedagogëve të huaj si pjesë e projekteve.

Rekomandime

1. Promocion dhe marketim i mëtejshëm në trevat shqipfolëse dhe më gjerë. – Kjo do të rrisë numrin e studentëve nga këto treva duke diversifikuar pjesëmarrjen e studentëve.
2. Rritja e përfshirjes së KU Beder në projektet e kërkimit shkencor në rrjet më universitetet e tjera. – Kjo do ti shërbente mobilitetit të studentëve dhe pedagogëve si edhe shkëmbimit të informacionit për përfshirjen e teknologjive digjitale dhe AI si pjesë e seminareve të veçanta gjatë programit Master i Shkencave.
3. Diversifikimi i burimeve financiare të KU Beder për të rritur peshën specifike të të ardhurave të tjera ndaj donacioneve.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences "Communication Sciences" with profiles: "Public Relations"; "Journalism" provided by the Higher Education Institution "Bedër University College".

Strengths and affirmations

1. Institutional Framework and Infrastructure - The program is offered within a well-established private higher education institution in Albania, with adequate infrastructural capacities for its implementation.
2. Qualified Academic Staff - The program is covered by academic staff holding relevant scientific degrees and with experience in the field of communication. The involvement of lecturers with practical experience in media and PR adds value to teaching and strengthens the program's link to the job market.
3. Curriculum Structure and Content - The curriculum is well-structured, maintaining a balance between theoretical and practical components, appropriate for the second cycle level. The inclusion of professional practice and modules focused on developing applicable skills is a positive element.
4. Student Support and Research Activity - Students benefit from mentoring and academic guidance throughout the entire study cycle. The program encourages student involvement in research projects and participation in conferences and academic publications.
5. Relevance to Labor Market Needs - The program addresses current labor market demands in the fields of communication, media, and public relations across both public and private sectors.

Weaknesses

1. Increasing participation and involvement in international projects/networks with other international universities, to include new communication technologies in the curriculum. – KU Beder has managed to be part of several international projects, but again, there is a need to increase participation in these international university networks by focusing on the use of new digital technologies and AI. These could also be in the form of special seminars for students of this program.
2. The need for further diversification of financial resources to support study programs. – Over the years, the university college has shown financial stability, but the share of the budget that comes from "donations, insurance activities and foundations, etc.", continues to be high, around 49%. KU Beder should search for other opportunities to increase and include other income in financial opportunities.
3. Low international promotion of the program and especially in Albanian-speaking areas in the nearby countries - KU Beder should strengthen the marketing component of the

program by attracting more students from Albanian-speaking neighbouring countries. This will be an important step towards wider international recognition, as well as the participation of foreign students or lecturers as part of the projects.

Recommendation

1. Further promotion and marketing in Albanian-speaking neighbouring countries, and more – This will increase the number of students from these regions by diversifying student participation.
2. Increasing the involvement of KU Beder in scientific research projects in the network with other universities. – This would serve the mobility of students and lecturers as well as the exchange of information on the inclusion of digital technologies and AI as part of special seminars during the Master of Science program.
3. Diversifying KU Beder's financial resources to increase the specific weight of other income rather than donations.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X